



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 478 Akti

Nr. 364.Vendimi
Tiranë, më 2.4.2021

V E N D I M

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleđa Çiftja	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datat 10.3.2021, ora 12:30 dhe 31.3.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve salla B, kati 0 Tiranë, zhvilloi seancat dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Znj. Alma Hicka, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Hicka, në seancat dëgjimore të zhvilluara me të, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Znj. Alma Hicka është subjekt rivlerësimi, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit të saj si gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Znj. Alma Hicka, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të

rivlerësimit, duke u shortuar në datë 11.5.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisioneret: Etleda Ciftja, Firdes Shuli dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Me hedhjen e shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, për subjektin e rivlerësimit Alma Hicka, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues, komisioneren Etleda Ciftja. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Në përputhje me “Hapat proceduralë të unifikuar”, subjekti i rivlerësimit u njoftua për fillimin e procedurave të rivlerësimit, për deklarimin e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës.

i) Komisioni pas shortimit të kësaj çështje prioritare verifikoi së pari statusin e subjektit të rivlerësimit.

ii) Znj. Alma Hicka u caktuar me vendimin nr. ***, datë 6.2.2020,¹ të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për transferimin e gjyqtarës Alma Hicka në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

iii) Me qëllim vlerësimin e statusit juridik të znj. Alma Hicka, u ndërmorën këto hapa:

- me shkresën nr. *** prot., datë 9.6.2020, iu kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dosja e plotë profesionale që disponohej prej këtij institucioni në lidhje me karrierën e subjektit të rivlerësimit.

- me shkresën nr. *** prot., datë 15.6.2020 KLGJ-ja vuri në dispozicion dosjen e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimit të Magjistratëve për subjektin e rivlerësimit.

iv) Komisioni pasi administroi dokumentacionin lidhur me karrierën profesionale evidentoi se:

- me dekretin nr. 4313, datë 16. 6.2004, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, znj. Alma Hicka është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë;

- me vendimin nr. ***, datë 15.9.2010, të KLD-së, znj. Alma Hicka është emëruar Inspektore në Inspektoratin e KLD-së, funksion të cilën e ka ushtruar deri në vitin 2013;

- me vendimin nr. ***, datë 16.12.2013, të KLD-së, znj. Alma Hicka i është dhënë pëlqimi për të shërbyer si Avokate e Përgjithshme e Shtetit.

v) Ligji nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, parashikonte se²: “Gjyqtarët mund të shërbenin në nivele drejtuese ose ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë, por, në ndryshim nga ligji organik “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”, ky ligj nuk përcaktonte afat për ushtrimin e funksioneve pranë strukturave të Ministrisë së Drejtësisë”. Sipas këtij ligji, gjyqtarët a prokurorët mund të riemëroheshin përsëri me kërkesë të tyre.

neni 4 Statusi i funksionareve politike dhe i nëpunësve civile (ndryshuar me ligjin nr. 9112, datë 24.7.2003): “Gjyqtarët dhe prokurorët mund të shërbejnë si këshilltarë ligjore dhe në nivele drejtuese ose ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë. ”Gjyqtarët a prokurorët që shërbejnë në strukturat e përmendura në piken 3 të këtij neni, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë a prokurorë pa konkurs.”

vi) Në vijim, znj. Alma Hicka, ka paraqitur kërkesë KLD-së, në cilësinë e Inspektore, me objekt marrje pëlqimi për ushtrimin e funksionit të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, duke dhënë njëkohësisht dorëheqjen nga funksioni i Inspektorit.

- KLD-ja me vendimin nr. ***, datë 16.12.2013, i ka dhënë pëlqimin znj. Alma Hicka për të shërbyer si Avokate e Përgjithshme e Shtetit. Znj. Alma Hicka ka vazhduar në këtë funksion deri në 22.10.2018, datë kur është liruar nga detyra e Avokates së Përgjithshme të Shtetit.

vii) Me vendimin nr. ***, datë 6.2.2020, KLGJ vendosi transferimin e gjyqtares Alma Hicka në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas shqyrtimit të kërkesës së saj për kthimin në sistemin gjyqësor pas përfundimit të periudhës së komandimit në një institucion brenda sistemit të drejtësisë.

viii) Komisioni pasi kërkoi dosjen e plotë që lidhet me transferimin e subjektit Alma Hicka në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe administroi e analizoi dokumentacionin vlerëson se: znj. Alma Hicka gëzon statusin e subjektit të rivlerësimit referuar parasikimeve të ligjit nr. 84/2016, duke vijuar hetimin administrativ.

5. Subjekti i rivlerësimit znj. Alma Hicka i ka parashkruar trupit gjykues kërkesa në datat 20.5.2020, 22.5.2020, 15.12.2020, 17.12.2020, 21.12.2020 dhe 23.12.2020 të cilave trupi gjykues i ka dhënë përgjigje në respektim të ndërjegjësimit të subjektit të rivlerësimit si palë në procesin administrativ.

6. Në respektim të barazisë së armëve në proces, përveç sa më sipër, trupi gjykues nuk ka penguar, kufizuar, ndryshuar apo pakësuar pyetjet edhe komentet e subjektit të rivlerësimit për procedurën e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, duke respektuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit si palë në proces për të bërë komente mbi përgjigjet apo procedurën.

7. Në vijim për t'i mundësuar subjektit të rivlerësimit krijimin e mundësisë reale për mbrojtjen efektive në proces nëpërmjet kohës së mjaftueshme ka mundësuar si vijon:

i) trupi gjykues pas njoftimit të subjektit mbi rezultatet e hetimit dhe afatit të sjelljes së përgjigjeve është njohur me kërkesën e subjektit për shtyrjen e afatit me një kohë shtesë për t'i mundësuar paraqitjen e qëndrimit në lidhje me gjetjet, si dhe për mbledhjen e provave të nevojshme për të përgatitur një ekspertizë financiare.

ii) **Trupi gjykues ka njoftuar** subjektin se ka shtyrë afatin për paraqitjen e provave dhe shpjegimeve nga data 29.12.2020 në datën 15.1.2021.

iii) Në datën 12.1.2021, subjekti i rivlerësimit Alma Hicka, njoftoi Komisionin se në lidhje statusin e procedurave për të mbledhur provat që konsideronte të nevojshme për mbrojtjen disa kërkesa nuk kishin marrë përgjigje, ndaj kërkonte shtyrjen e afatit për përgjigje me qëllim që t'i mundësohej të analizonte përgjigjet dhe t'i procesonte ato në logjikën e mbrojtjes së saj.

iv) Trupi gjykues, pasi u njoh me kërkesën dhe e vlerësoi atë, vendosi t'i japë subjektit të rivlerësimit Alma Hicka edhe 20 ditë të tjera kohë shtese, duke njoftuar subjektin se afati për sjelljen e provave e shpjegimeve shtyhej nga 25.1.2021 deri në datën 12 shkurt 2021.

8. Subjekti i rivlerësimit Alma Hicka solli shpjegimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës, brenda afatit në datë 11.2.2021.

9. Trupi gjykues, pas analizimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, vendosi ta ftojë atë në seancën dëgjimore në datën 10.3.2021, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016,

10. Në seancën dëgjimore, subjekti rivlerësimit, znj. Alma Hicka deklaroi se kishte paqartësi mbi disa barra prove të dërguara nga Komisioni, dhe pas njohjes me këtë pretendim, trupi

gjykues vendosi t'i japë subjektit të rivlerësimit, shpjegime shtesë për dy nga barra prove të dërguara nga Komisioni lidhur me huat e prindërve, përdorur si burim krijimi për pasuritë e deklaruar prej saj si subjekt rivlerësimi dhe lidhur me një rast konflikti interesit.

11. Ky vendim i marrë trupi gjykues për të mos lejuar që subjekti i rivlerësimit të vendosej në një gjendje të pafavorshme për shkak të mungesës së mundësisë për të marrë informacion apo mësuar mbi fakte që i nevojiteshin subjektit për të siguruar një mbrojtje efektive.

12. Trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për afatin kohor një javor shtesë për sjelljen e shpjegime shtesë nëse do të kishte të tilla, për barrat e provës dërguar në mënyrë më të shtjelluar nga ana e Komisionit.

13. Në datën 26.3.2021, subjekti i rivlerësimit Alma Hicka solli shpjegime dhe prova shtesë lidhur me barrat e provës dërguar në mënyrë të shtjelluar nga ana e Komisionit.

14. Pasi analizoi shpjegimet shtesë të subjektit të rivlerësimit Alma Hicka, trupi gjykues e ftoi atë në vijimin e seancës dëgjimore në datën 31.3.2021, ora 10:00 në Pallatin e Koncerteve.

I. SEANCA DËGJIMORE

15. Në datat 10.3.2021, ora 12:30 dhe 31.3.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve u zhvilluan seancat dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka dhe në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit Alma Hicka u paraqit personalisht në seancat e zhvilluara dhe në përfundim të tyre kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 31.3.2021, ora 10:00, u ndërpre për të vazhduar në datën 2.4.2021 me shpalljen e vendimit të trupit gjykues.

II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit Alma Hicka ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit administrativ, në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

A. VLERËSIMI I PASURISË

17. ILDKPKI ka kryer kontrollin e plotë të pasurisë së subjektit Alma Hicka, duke krahasuar deklaratën e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*, deklaratat e pasurisë në vite, si dhe dokumentacionin justifikues bankar, jobankar etj., të dorëzuar nga subjekti dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka konstatuar se për subjektin Alma Hicka;

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar burimin e huave nga babai;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti ka ushtruar funksionin në situatën e konfliktit të interesave.*

A/1. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

18. Pavarësisht se sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ILDKPKI-ja është autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017³,

³ "41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: "Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit". Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja

të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kreu një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke hetuar në mënyrë të pavarur të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, nga ku rezultoi si vijon:

19. Pasuria apartament banimi me sipërfaqe 120.3 m²,

19.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “kontratë prenotimi për apartament me sip. 120.3 m² (kursime nga paga të ardhurat e tjera të deklaruara këtu, të ardhura nga qiratë dhe kredi bankare) i paregjistruar ende. Vlera: 90.000 euro.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

19.2. Në seksionin “detyrime financiare ndaj personave juridike dhe fizike” të deklaratës *Vetting* subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar detyrim për kontratën e prenotimit të apartamentit në shumën 4.000 euro. Ndërsa te seksioni “ të dhëna konfidenciale”, ka deklaruar kontratë prenotimi apartamenti nr. 326/110/1, datë 14.5.2015, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasve Alma e E. Hicka.

19.3. Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti nr. ***, datë 14.5.2015, bashkë me dokumentacionin pjesë integrale të saj; (ii) kontratë kredie afatgjatë nr. ***, datë 23.12.2016, lidhur midis “Societe Generale Albania” dhe shtetasve Alma e E. Hicka; (iii) kontratë hipotekimi nr. ***, datë 23.12.2016; (iv) kartelë e pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 75.21 m².

19.4. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 subjekti ka deklaruar: “...kontratë porosie për apartament 90.000 euro”. Në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridike apo fizike pjesë e DPV-së 2015 subjekti ka deklaruar “detyrim për pagim çmimi për kontratë sipërmarrje për ndërtim apartamenti shuma e shlyer deri në 31 dhjetor shuma 63.000 euro...” “...gjendja e detyrimit të mbetur 27.000 euro”. Në seksionin të dhënave konfidenciale në DPV-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar: “Huamarrje babait të deklaruases shtetasit H. F. B. e deklaruar në këtë deklaratë për blerje apartamenti”.

19.5. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, subjekti, ka deklaruar⁴ detyrim për pagim të çmimit të kontratës së sipërmarrjes deklaruar në DPV-në e vitit 2015, shuma e paguar 23.000 euro dhe detyrim të mbetur pa paguar deri në datën 31.12.2016, në vlerë 4.000 euro.

19.6. UK Tiranë⁵, ka konfirmuar se në emër të personit të lidhur E. H. rezulton kontrata me numër *** në rruga “****”, kompleksi “****”.

19.7. OSHEE⁶, ka konfirmuar se me gjeneralitetet E. H. referuar të dhënave të sistemit të faturimit identifikohet abonent me kontratën e furnizimit, në Tiranë, rruga “****” me datë fillimi të kontratës më 17.6.2016.

19.8. Me kontratën e sipërmarrjes për prenotim apartamenti datë 14.5.2015, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti në cilësinë e porositësit, kanë porositur të sipërmarrësi shoqëria “****” sh.p.k., apartamentin e ndodhur në Kompleksin Rezidencial “****”, në rrugën “****”, Tiranë, me sipërfaqe 120.3 m², kundrejt çmimit prej 90.000 euro. Në kontratë është parashikuar pagesa e çmimit si vijon: (i)-shuma 3.000 euro do të paguhej deri në datën 15.5.2015; (ii) shuma 24.000 euro do të paguhej deri në datën 30.5.2015; (iii) shuma 36.000

gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

⁴ Seksioni mbi detyrimet financiare ndaj personave juridike apo fizike.

⁵ Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 3.6.2020, nga UKT-ja

⁶ Shkresë kthim përgjigje, datë 22.5.2020.

euro do të paguhej deri në datën 30.4.2016, me dorëzimin e çelësave të apartamentit objekt kontrate; (iv) shuma 4.000 euro do të paguhej me dorëzimin e hipotekës.

Analiza e burimeve të krijimit për këtë pasuri

19.9. Në deklaratën *Vetting* burim për blerjen e apartamentit janë deklaruar kursime nga paga të ardhura nga qiratë dhe kredi bankare, ndërsa në deklarinimin periodik vjetor për vitin 2015, është deklaruar huamarrje në vlerën 5.000.000 lekë për blerje apartamenti, dhe është përcaktuar se huamarrja ka qenë nga z.H. B., babai i subjektit.

19.10. Sa më sipër, subjekti ka kryer deklarime të ndryshme në deklaratën *Vetting* me atë periodike vjetore 2015 lidhur me burimin e krijimit për këtë pasuri duke mos e deklaruar në deklarinimin *Vetting*, huan në shumën 5.000.000 lekë marrë si pjesë e burimit për krijimin e këtij apartamenti.

19.11. Kredia bankare e deklaruar si burim në deklaratën *Vetting* dhënë në datë 23.12.2016, nga banka “Societe Generale Albania” në shumën 3.000.000 lekë, është disbursuar më vonë⁷ në kohë se pagesat e kryera për apartamentin, të cilat rezultojnë të kenë përfunduar në datën 27.5.2016, për rrjedhojë, ajo nuk mund të këtë shërbyer për likuidimin e çmimit të kësaj pasurie.

19.12 Për të analizuar burimet e të ardhurave për mundësinë e pagimit të çmimit të apartamentit, Komisioni iu referua deklarimeve të subjektit, ndër vite, si dhe deklarimit në deklaratën *Vetting* duke i analizuar ato si më poshtë vijon:

a) Hua nga prindërit e subjektit në shumën 5.000.000 lekë

19.13. Subjekti nuk ka deklaruar këtë burim krijimi në deklaratën *Vetting*, ndryshe nga sa në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar si burim huan 5.000.000 lekë nga prindërit e saj.

19.14. Me aktmarrëveshjen⁸ e datës 13.11.2015, lidhur midis subjektit dhe personit të lidhur në cilësinë e huamarrësve dhe prindërve të subjektit në cilësinë e huadhënësve, palët kanë përcaktuar se: *“Kjo aktmarrëveshje rregullon të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta të palëve në lidhje me detyrimin monetar prej 4.260.000 lekë që huadhënësit i kanë dhënë huamarrësit për efekt të pagimit të një pjese të çmimit (në datë 1.12.2015 dhe 2.12.2015) të kontratës nr. ***, datë 14.5.2015, që huamarrësit kanë lidhur me shoqërinë ‘***’ sh.p.k., për blerjen e një apartamenti banimi, huamarrësit marrin përsipër të kthejnë shumën e marrë hua brenda një afati 5-vjeçar duke nisur nga dita e lidhjes së kësaj aktmarrëveshje”.*

19.15. Nga verifikimi i dokumentacionit financiar/bankar të administruar nga Komisioni⁹ rezulton se nga llogaria e nënës së subjektit, znj. N. B., pranë Bankës së Shqipërisë janë maturuar bonot e thesarit, datë 12.11.2015, në shumën 2.993.128 lekë, të cilat më pas janë kredituar në llogarinë e saj personale në “ABI Bank”. Nga kjo llogari në datën 1.12.2015 është kryer pagesa në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. në vlerën 3.001.500 lekë me përshkrim “pagesë për llogari të Alma Hicka për shlyerje të këstit të dytë sipas kontratës 14.05.2015 për “****” sh.p.k.”.

19.16. Gjithashtu, nga llogaria e nënës së subjektit në BKT, në datën 1.12.2015, pasi është maturuar depozita me afat, është kryer pagesa prej 1.260.000 lekësh në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. me përshkrim *“pagesë këst apartamenti sipas kontratës datë 14.5.2015, për llogari të Alma Hicka”.* Pjesa tjetër është paguar cash, sipas deklarimit të subjektit.

⁷ Kredia është disbursuar në datën 23.12.2016 dhe nuk mund të përdorej për pagesën e kryer në datën 27.5.2016.

⁸ Marrëveshje pa noter midis palëve pjesë e përgjigjes së dërguar nga OTP Bank nr. *** prot., datë 21.5.2020.

⁹ Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.5.2020, nga Banka e Shqipërisë; Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.5.2020, nga ABI Bank; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 3.6.2020, nga BKT.

19.17. Në analizë të dokumentacionit për sa është konfirmuar marrëdhënia e huas, qoftë nga huadhënësit (prindërit e subjektit), ashtu edhe nga huamarrësit (subjekti dhe personi i lidhur). Në zbatim të kërkesave të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të justifikojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të likuiditeteve të dhëna hua nga huadhënësit (prindërit e saj), duke paraqitur dokumentacion ligjor provues për ligjshmërinë e të ardhurave për këtë hua të dhënë dhe arsyet e mosdeklarimit të saj në deklaratën vetting si burim krijimi.

19.18. Subjekti i rivlerësimit, deklaroi se: *“në lidhje me deklarin e burimit të krijimit të pasurive në deklaratën Veting, në rastin kur huat kanë qenë të shlyera, kam arsyetuar se ato janë paguar në mënyrë përfundimtare me të ardhurat dhe kursimet familjare, ndërsa në rastin kur huaja nuk është shlyer plotësisht kam deklaruar huan në vijim, si burim i krijimit të pasurisë. Në logjikën time burimi i krijimit të një pasurie pasi është shlyer huaja që fillimisht është marrë për të, nuk është më huaja, por të ardhurat që kanë kontribuar për të shlyer huan”*.

19.19. Lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së dhënë hua subjekti ka shpjeguar se: *“të ardhurat e prindërve të mi për krijimin e shumave që më kanë dhënë hua janë krijuar nga puna e babait tim në shoqërinë “***” sh.p.k., Lushnjë, deri në vitin 2013, puna e tij në Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, deri në vitin 2018, aktiviteti privat i shitjes së mamasë time në Lushnjë (siç e kam deklaruar në deklarata e vitit 2003 dhe 2004), deri në vitin 2013. Pasuria e prindërve të mi ka qenë në depozita bankare përpara marrjes së huas dhe gjendet aktualisht edhe sot, që tregojnë se ata kanë disponuar në të gjitha momentet që më kanë dhënë hua pasuri të mjaftueshme, në likuiditete bankare...”*

Lidhur me të ardhurat e babait të subjektit, z. H. B.

19.20. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar nga Komisioni¹⁰, evidentohen të ardhurat e z. H. B. (babai i subjektit) nga punësimi, për periudhën korrik 2005 - janar 2013, të cilat kanë qenë afërsisht në vlerën 3.500.000 lekë, ndërsa për periudhën janar 2013 deri në kohën e dhënies së huas së deklaruar (dhjetor 2015), babai i subjektit nuk figuron i punësuar dhe punësimi i tij pranë Ujësjetllës Kanalizimeve Tiranë ka filluar në prill të vitit 2016.

19.21. Subjekti, gjatë shpjegimeve në pyetësorët e dërguar, ndër të tjera, ka referuar se: *“..puna e babait tim në shoqërinë “***” sh.p.k. provohet edhe nga vendimi gjyqësor i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 27.5.2013. Në këtë vendim përcaktohet edhe vjetërsia në punë nga 1.8.1995 – 31.1.2013, si edhe paga bazë”*.

19.22. Lidhur me sa më sipër iu kërkua subjektit të paraqiste në cilësinë e provës, vendimin e gjykatës me ekstremitetet e dokumentit zyrtar, nënshkruar nga gjyqtari, vulosur dhe njësuar nga kancelari i gjykatës.

19.23. Komisioni i ka kërkuar¹¹ dhe shoqërisë në falimentim “***” sh.p.k., të dhëna lidhur me punësimin, dhe të ardhurat e përfituara e z. H. B..

19.24. Administratorja e falimentit të shoqërisë “***” sh.p.k., ka konfirmuar se: *“Nga viti 1994 – 31.01.2013 listë-pagesat e punonjësve dorëzoheshin pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.”, lidhur me pagesat e kryera, nuk disponoj dokumentacionin e kërkuar konfirmoj se H. B. gjatë procesit të falimentimit të shoqërisë “***” sh.p.k., shoqëri në falimentim ka përfituar dëmshpërblim sipas vendimit të gjykatës nr. **, në shumën prej 519.552 lekë, nga shpërndarja e masës së falimentimit sipas vendimit nr. *** Akti, datë vendimi 25 korrik 2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”*.

¹⁰ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2020, nga “Raiffeisen Bank”; (ii) shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.5.2020, nga ISSH.

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 11.09.2020 e KPK-së.

Lidhur me të ardhurat e nënës së subjektit, znj. N. B.

19.25. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, subjekti ka deklaruar: “...të ardhura nga vetëpunësimi i nënës...50.000 lekë /muaj...vetëpunësimi në treg si shitëse ambulante..”, ndërsa në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 ka deklaruar: “.të ardhura nga puna për nënën N. B....800.000 lekë/vit gjithsej...tregu fruta – perime në Lushnjë.”.

19.26. Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti tregtar i personit tjetër të lidhur znj. N. B., Komisioni ka kërkuar të dhëna/informacion pranë Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, e cila ka informuar¹² se për znj.N. B., nuk dispononte asnjë të dhënë për punësimin, vetëpunësimin apo ndonjë aktivitet tregtar.

19.27. Në përgjigje të pyetësorit II, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “*specifikisht, në vitin 2003 dhe 2004, mamaja ime ka deklaruar të ardhura nga vetpunësimi në tregun fruta-perime Lushnjë, si shitëse¹³, në vitin 2003, 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj dhe në vitin 2004, të ardhura totale prej 800,000 (tetëqind mijë) lekësh. Për këtë punë mamaja ime kujton se ka paguar një tarifë ditore që merrej nga Bashkia Lushnjë, por nuk ka paguar sigurime shoqërore e shëndetësore dhe prandaj gëzon sot pensionin minimal në shkallë vendi*”.

19.27. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar nga Komisioni, rezultoi se të ardhurat e dokumentuara të prindërve të subjektit, për të cilat ishin shlyer detyrimet tatimore, ishin më të vogla se shuma e dhënë hua prej 5.000.000 lekësh, pa konsideruar shpenzimet jetike të huadhënësve apo shpenzime të tjera të huadhënësve gjatë kësaj periudhe kohore.

19.28. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit lidhur me sa duket se:

i) ka mospërputhje midis deklaratës *Vetting* dhe deklarimit periodik në lidhje me burimet e krijimit të kësaj pasurie, pasi subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* huan e marrë nga prindërit si burim për këtë pasuri;

ii) mosprovim me dokumentacion ligjor përkatës, të burimit të ligjshëm të të ardhurave të prindërve që kanë shërbyer për dhënien e huas subjektit të rivlerësimit në vlerën prej 5.000.000 lekësh në vitin 2015.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

19.29. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, shpjegoi se: “*në lidhje me barrën e provës në përgjithësi dhe sidomos në lidhje më barrën e provës për huan e marra nga prindërit e mi, H. dhe N. B.. Në dokumentin tuaj të titulluar, rezultate hetimi për subjektin e rivlerësimit Alma Hicka ju më keni ngarkuar barrën e provës për të provuar të ardhurat e prindërve të mi H. dhe N. B., për shkak të tre huave të marra në kohë të ndryshme.*

Barra e provës e vendosur për huan është në tejkalim të parashikimeve ligjore dhe kushtetuese për vendosjen e barrës së provës dhe janë të paqarta faktet që kërkohet të provohen.

Ajo që ma bën pothuajse të pamundur situatën është fakti se për këtë më është kaluar barrë prove. Do isha shumë e gatshme të angazhohesha në procesin e të provuarit dhe do ta bëj me aq sa mundem, por nuk jam në gjendje të kuptoj ende se cilat janë faktet që duhet të provoj, pse deklarimi nuk është i saktë dhe pse deklarimet dhe provat e deritanishme nuk janë të

¹²Shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2020, nga DRT-ja Fier.

¹³Në këtë punë mamaja ime ka punuar fillimisht së bashku me një shoqe të saj dhe më pas ndihmohej nga babai im pas pune. Punësimi ishte arsyeja pse ata kanë qëndruar në Lushnjë, ndërsa unë dhe motrat e mia, që ndiqnin shkollën, banonim në Tiranë. Për këtë punë mamaja ime kujton se ka paguar një tarifë ditore që merrej nga Bashkia Lushnjë, por nuk ka paguar sigurime shoqërore e shëndetsore dhe prandaj gëzon sot pensionin minimal në shkallë vendi.

mjaftueshme. Barazia e armëve dhe kontradiktoriteti kërkojnë që Ju të sqaroni konkluzionet tuaja, me qëllim që unë si pala tjetër në këtë procedurë të mundem ti kundërshtoj ato.

Nëse konkluzionet tuaja nuk janë të qarta dhe s'kanë një arsyetim ligjor mbështetës, mua nuk më mbetet gjë tjetër përveçse të theksoj këtë veprim të kundërligjshëm nga ana Juaj si edhe të ritheksoj se deklarimi është plotësisht në përputhje me ligjin.

Në lidhje me paqartësinë e barrës së provës për burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve, që kanë shërbyer për dhënien e huave si edhe paligjshmërinë dhe antikushtetutshmërinë e procedurës për vendosjen e barrës së provës.

Duke konsideruar sa më sipër, nuk jam e qartë se për cilat fakte më është ngarkuar barra e provës. Megjithëse në lidhje me këtë kam këmbyer disa e-mail-e më Komisioni dhe përkatësisht trupin gjyqes të ngarkuar me procesin tim të rivlerësimit përsëri nuk kam marrë deri në sot asnjë sqarim”.

19.30. Trupi gjyqes, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës dhe në seancën e datës 10.3.2021, duke vlerësuar respektimin e parimit të barazisë së armëve dhe duke mbajtur parasysh të respektojë të drejtat e subjektit të rivlerësimit në këtë proces, për të mos lejuar që subjekti të vendosej në një gjendje të pafavorshme për shkak të mungesës për të marrë informacion apo mësuar mbi fakte që nevojiten për mbrojtjen e saj efektive, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave, *ex officio*, si dhe për të parandaluar çdo disavantazh, vlerësoi t'i japë subjektit të rivlerësimit shpjegimet shtesë lidhur me barrën e provës për huamarrjen nga prindërit në vitin 2015, si vijon:

19.31. Në vlerësim të faktit se subjekti i rivlerësimit edhe personat e tjerë të lidhur të deklaruar në cilësinë e huadhënësit, kanë konfirmuar këtë marrëdhënie, referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, ato kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre pasurive, likuiditet dhëna hua.

19.32. Detyrimi ligjor dhe kushtetues gjatë procesit të rivlerësimit është justifikimi dhe argumentimi me dokumente shoqëruese i ligjshmërisë së burimit të krijimit të kësaj pasurie, likuiditet dhënë hua, përdorur si pjesë e çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 120.3 m², në Tiranë.

19.33. Subjekt rivlerësimit që në pjesën “Deklarimi i pasurisë” kishte detyrimin ta deklaronte në deklaratën e pasurisë *Vetting*, jo vetëm pasurinë apartament me sipërfaqe totale 120.3 m², në Tiranë, por dhe burimet që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie në momentin e krijimit të saj në vitin 2015.

19.34. Në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2015 (*në detyrimeve financiare ndaj personave juridike apo fizike*), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar – *detyrim huamarrje në shumën 5.000.000 lekë për blerje apartamenti*, duke konfirmuar se qëllimi i kësaj huaje ka qenë për blerjen e këtij apartamenti, dhe se kjo hua ka shërbyer si burim i krijimit të kësaj pasurie.

Lidhur me të ardhurat nga marrëdhëniet e punës të z. H. B. (babai i subjektit)

19.35. Referuar informacionit nga ISSh-ja¹⁴ rezulton se z. H. B. për periudhën janar 2012 – janar 2013, ka qenë i punësuar në shoqërinë “****” sh.p.k., me NIPT **** dhe më pas deklarohet si i punësuar (nga muaji prill i vitit 2016), nga UK Tiranë.

19.36. Drejtoria e Arkivit Qendror të Sigurimeve, nuk ka përcjellë informacion pranë Komisionit për periudhën 1994 – 2012.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 18.5.2020.

19.37. Nga të dhënat e “Raiffeisen Bank”¹⁵, rezultojnë se z. H. F. B. (datëlindja 7.6.1953), ka pasur llogari rrjedhëse në lekë nr. ***, hapur në datën 21.7.2005. Kjo llogari është kredituar nga 21.7.2005 deri 27.11.2012 (paga, shpërblime+ushqime) në vlerat:

Viti	Të ardhura në lekë (kredituar llogaria e pagës në “Raiffeisen Bank”)
2005	219.080
2006	488.119
2007	443.906
2008	469.540
2009	483.222
2010	467.595
2011	525.999
2012	422.223
Totali	3.519.684

19.38. Ndërsa për periudhën dhjetor 2012 – janar 2013, referuar të dhënave nga ISSH, për z. H. B. nga shoqëria “****” sh.p.k. është deklaruar pagë *bruto* në total në vlerën 86.592 lekë, të cilës i korrespondon e ardhur *neto* në vlerën 68.235 lekë.

19.39. Administratorja e falimentit të shoqërisë “****” sh.p.k., ndër të tjera, ka konfirmuar¹⁶ se: “... z. H. B., gjatë procesit të falimentit të shoqërisë “****” sh.p.k., shoqëri në falimentim, ka përfutuar dëmshpërblim sipas vendimit të gjykatës nr. ***, në shumën 519.552 lekë, nga shpërndarja e masës së falimentit sipas vendimit të aktit ***, datë 25.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë...”.

19.40. Pra, të ardhurat e dokumentuara nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. H. B. nga paga rezultojnë në vlerën 3.587.919 lekë deri në janar të vitit 2013, duke vlerësuar edhe faktin se dëmshpërblimi i përfutuar sipas vendimit të gjykatës i përket një periudhë kohore, pas dhënies së huave subjektit të rivlerësimit

Lidhur me të ardhurat e znj. N. B. (nëna e subjektit)

19.41. Drejtorja Rajonale Tatimore Fier¹⁷ informoi se znj. N. B. nuk rezultojnë e regjistruar, si përfaqësuese e ndonjë subjekti tatimor apo kontribuuese e sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësore pranë DRT-së Fier deri në datën 18.9.2020.

19.42. Bashkia Lushnjë¹⁸ informoi ILDKPKI-në se znj. N. B. nuk figuron e regjistruar në Drejtorinë e të ardhurave vendore për ushtrim aktiviteti privat.

19.43. Në bazë të ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, kreu II, neni 3, është përcaktuar se: “subjekte të tatimit me kuotë fikse, janë ato subjekte që realizojnë një qarkullim deri në shumën 2.000.000 lekë në vit:1)Tregtim e shërbim ambulator (për rrethin e Lushnjës kategoria II, paguajnë tatim me kuotë fikse 20.000 lekë/vit) ndërsa referuar nenit 4 të këtij ligji (Regjistrimet dhe detyrimet ndaj tij), në pikën 1 është përcaktuar se çdo person që kërkon të fillojë një biznes, duhet të regjistrohet në zyrën e tatimeve të rrethit ku ai e ushtron veprimtarinë e tij”.

19.44. Me ligjin nr. 8842, datë 11.12.2001, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, ndryshuar me ligjin nr. 8715, datë 15.12.2000, paragrafi i parë i nenit 3 ”tatimi me kuotë fikse” është ndryshuar dhe në germën

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2020.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 28.10.2020.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2020.

¹⁸ Shkresë nr. *** Prot., datë 10.4.2018.

“dh”, pika 1 dhe 4 , përcaktohet: “1)...Tregti ambulante (për rrethin e Lushnjës kategoria II, paguajnë tatim me kuotë fikse 10.000 lekë/vit)4)Në tregje të miratuara nga bashkia për shitje me pakicë fruta –perime dhe mallra të përdorura (për rrethin e Lushnjës kategoria II, paguajnë tatim me kuotë fikse 10.000 lekë/vit)”.

19.45. Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, në nenin 9 në llojet e taksave vendore është përfshirë edhe: “ 1) taksa vendore mbi biznesin e vogël ndërsa në nenin 11, pika 1”. Kategoritë minimale të bazës së taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe nivelet treguese të taksës, për çdo kategori, jepen në aneksin 5, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Referuar këtij Aneksi për ambulantët e përfshirë në kategorinë II, niveli i kësaj takse është 5.000 lekë/vit.

19.46. Pra sa më sipër, legjislacioni ka pasur parashikim për regjistrim dhe pagesë tatimi/taksë edhe për ambulantët, përfshirë edhe ata që ushtrojnë aktivitetin në tregjet e miratuara nga bashkitë.

Lidhur me të ardhura të tjera /aksione /interesa etj.

19.47. Drejtoria Rajonale Tatimore Fier¹⁹ informon se shtetasi H. B. rezulton i regjistruar si aksioner nga datë 28.2.2017, te subjekti tatimor “***”, me NIPT ***, ndërsa shtetasja N. B. nuk rezulton e regjistruar si përfaqësuese e ndonjë subjekti tatimor apo kontribuese e sigurimeve shoqërore e shëndetësore deri në 2.6.2020.

19.48. Referuar ekstraktit historik të QKB-së rezulton se ortakë H. B. ka nr. ** në radhën e ortakëve të kësaj shoqërie me 0.19% të pjesëmarrjes në kapital në shumën 1.900 lekë (kapital 1.000.000 lekë).

19.49. Banka e Shqipërisë²⁰ ka informuar Komisionin se znj. N. B., ka investuar në datën 21.1.2003, shumën 1.000.000 lekë, në Bono Thesari me maturim 6-mujor. Në datën 31.12.2003 shuma e investuar ka qenë 940.134 lekë.

19.50. Për periudhën 21.1.2003 – 12.11.2015, znj. N. B. (nëna e subjektit) ka përfituar shumën 1.861.542 lekë nga interesat e bonove të thesarit, ndërsa z. H. B. (babai i subjektit) ka përfituar shumën 1.921.721 lekë (deri në datën 28.5.2015). Gjendjet e investimeve në Bono Thesari të prindërve për periudhën 2003 – 2014, paraqiten si vijon:

Vitet	Gjendjet investimi në Bono Thesari		
	Babai	Nëna	Total
2003	1.400.000	940.134	2.340.134
2004	1.500.000	1.300.000	2.800.000
2005	1.800.000	650.000	2.450.000
2006	2.500.000	1.639.277	4.139.277
2007	2.500.000	2.140.000	4.640.000
2008	2.500.000	3.000.000	5.500.000
2009	2.520.000	3.000.000	5.520.000
2010	2.510.000	3.000.000	5.510.000
2011	3.010.000	3.000.000	6.010.000
2012	3.500.000	3.000.000	6.500.000
2013	3.500.000	3.000.000	6.500.000
2014	3.500.000	3.000.000	6.500.000

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.6.2020.

²⁰ Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 31.7.2020.

19.51.Sa më sipër, deri në datë 31.12.2014, prindërit e subjektit kanë investuar në Bono Thesari shumën 6.500.000 lekë.

19.52.Nga të dhënat e “ABI²¹ Bank” rezulton se znj. N. B. ka pasur llogari për Bono Thesari në monedhën lekë pranë kësaj banke hapur në datën 27.4.2015 dhe mbyllur më 17.4.2019. Referuar lëvizjeve në këtë llogari në datën 1.12.2015, nëna e subjektit ka transferuar në llogari të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., shumën 3.001.500 lekë, me përshkrimin “pagesë për llogari të Alma Hicka, për shlyerje të këstit të dytë të kontratës, datë 14.5.2015, me ‘***’ sh.p.k.”.

19.53.Referuar të dhënave nga BKT²², rezulton se znj. N. B. ka hapur llogari depozitë në lekë, në këtë bankë në vitin 2006, ecuria e kësaj depozite deri në vitin 2015, rezulton:

Viti	Gjendje në llogari depozite në BKT në datën 31 dhjetor
2006	200.592
2007	0
2008	430.000
2009	60.000
2010	1.060.517
2011	1.060.517
2012	1.030.517
2013	1.480.549
2014	1.200.000
2015	0

Në datën 1.12.2015 është transferuar shuma 1.260.000 lekë me përshkrimin “N. H. B., pagesë kësht apartamenti sipas kontratës datë 14.05.2015, për llogari të Alma Hicka”

19.54. Referuar dokumentacionit financiar/bankar, prindërit e subjektit kanë disponuar për periudhën 2003-2015, këto vlera monetare gjendje²³ në llogari bankare dhe në investime Bono Thesari të Bankës së Shqipërisë, sa më poshtë:

Viti	Babai i subjektit				Nëna e subjektit		Totale (në lekë)	Ndryshim gjendje shtuar/pakësu ar nga viti i mëparshëm
	Raiffeisen Bank	BSH	BKT	BKT	BSH	BKT		
	llog. page (në lekë)	b. thesari (në lekë)	llog. dep euro (konv)	llog. dep (në lekë)	b. thesari (në lekë)	llog. dep (në lekë)		
2003		1.400.000			940.134		2.340.134	
2004		1.500.000			1.300.000		2.800.000	459.866
2005	94.123	1.800.000			650.000		2.544.123	-255.877
2006	34.344	2.500.000			1.639.277	200.592	4.374.213	1.830.090
2007	14.639	2.500.000			2.140.000	0	4.654.639	280.426
2008	19.638	2.500.000			3.000.000	430.000	5.949.638	1.294.999
2009	57.569	2.520.000			3.000.000	60.000	5.637.569	-312.069
2010	29.659	2.510.000			3.000.000	1.060.517	6.600.176	962.607
2011	23.158	3.010.000	683.744	1.212.377	3.000.000	1.060.517	8.989.796	2.389.620
2012	1.382	3.500.000	686.992	1.777.968	3.000.000	1.030.517	9.996.859	1.007.063
2013	0	3.500.000		2.597.543	3.000.000	1.480.549	10.578.092	581.233

²¹ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 18.5.2020.

²² Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 03.06.2020.

²³ Gjendjet i përkasin datës 31 dhjetor të çdo viti.

2014	0	3.500.000		2.700.000	3.000.000	1.200.000	10.400.000	-178.092
2015	0	3.385.511		2.500.000	0	0	5.885.511	-4.514.489

19.55. Bazuar në dokumentacionin e disponuar dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, nga Komisioni u krye një analizë financiare paraprake për periudhën 1.1.2004 – 1.12.2015²⁴, për të evidentuar mundësinë financiare të prindërve për krijimin e vlerave monetare në shumën 5.000.000 lekë dhënë hua subjektit (për blerje apartamentit në vitin 2015), kryerjen e shpenzimeve për konsum, si dhe shtimin e vlerave monetare në llogari bankare, konkretisht:

Analiza financiare periudha 1.1.2004 – 1.12.2015	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Gjendje në <i>cash</i> në datën 31.12.2003	0
Vlera monetare në bankë dokumentuar gjendje në datën 31.12.2003 (Banka e Shqipërisë investim në Bono Thesari)	2.340.134
Total vlera monetare dokumentuar në datën 31.12.2003 (1)	2.340.134
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat dhe shpërblimet babai i subjektit për periudhën	3.587.919
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat dhe shpërblimet nëna e subjektit për periudhën	0
Të ardhura nga aktiviteti tregtar, nëna e subjektit	0
Të ardhura nga interesat	4.479.036
Total të ardhura /të hyra financiare (2)	8.066.955
Hua dhënë subjektit shuma 5.000.000 lekë	5.000.000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën (2-4 persona)	4.386.557
Total shpenzime/të dala financiare (3)	9.386.557
Gjendje në <i>cash</i> në datën 1.12.2015	0
Vlera monetare në bankë dokumentuar gjendje në datën 1.12.2015	5.885.511
Total vlera monetare dokumentuar në datë 1.12.2015 (4)	5.885.511
Balanca e fondeve (1+2-3-4)	-4.864.979

19.56. Për sa më sipër, prindërit e subjektit nuk justifikojnë dhënien e huas vlerat monetare gjendje në llogaritë bankare, investimet në Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë, si dhe kryerjen e shpenzimeve për jetesë për periudhën 1.1.2004 – 1.12.2015.

19.57. Komisioni informoi subjektin se në analizat financiare të mësipërme nuk janë përfshirë pasuri, shpenzime të tjera të kryera nga huadhënësit, gjithashtu, janë llogaritur edhe interesa që mund t'i takojnë vlerave monetare me burim të pajustificuar të ardhurash.

19.58. Trupi gjykues i referoi subjektit se nga ana e saj nuk ishte dokumentuar gjendja e pamundësisë lidhur me të ardhurat e përfituara nga nëna e saj sipas përcaktimeve të parashikuara nga neni 32/2 i ligjit nr.84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje mbi shpjegimet shtesë nga Komisioni

19.59. “Së pari se ligjshmëria e të ardhurave dhe pagesa e detyrimeve tatimore janë dy koncepte të ndryshme për ligjin në tërësi dhe për ligjin nr.84/2016 dhe ligjet e taksa/tatimeve në veçanti. Qartazi në njërin anë keni të bëjmë me të ardhura dhe në anën tjetër me shpenzime (pagesë të detyrimeve tatimore). Këto dy koncepte nuk ka se si të barazohen apo nënkuptojë njëra tjetrën;

²⁴ Në vlerësim edhe të faktit se huaja në shumën 1.800.000 lekë e deklaruar e dhënë në vitin 2010, është shlyer për periudhën 2011 –2013.

Së dyti, se pagesa e detyrime tatimore është detyrim për subjektin e rivlerësimit, subjektin e lidhur dhe jo për personat e tjerë të lidhur (siç janë personat që gëzojnë cilësinë e huadhënësit);

Së treti, detyrimet tatimore qartazi paguhen edhe mbi të ardhura e paligjshme, prandaj ligjshmëria e të ardhurave dhe pagesa e detyrimeve tatimore janë dy koncepte të ndryshme të përcaktuara në mënyrë të pavarur, edhe nga ligji 84/2016 dhe gjithë legjislacioni tjetër në të cilin ai referon;

Në këtë dokument nuk gjej asnjë arsytim shtesë se përse këto argumente janë të pranueshme apo në kundërshtim me to, në mënyrë që mbi atë arsytim të bëjë kundërshtim e prandaj i qëndroj argumenteve të dhëna tashmë në dokumentin tim të dorëzuar në shkurt 2021.

19.60. Lidhur me pamundësinë referuar nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ndodhet në kushtet e këtij neni pasi i është drejtuar, institucioneve që kanë në dispozicion informacion mbi këtë kategori subjektësh duke mbajtur në konsideratë se kërkimi në DRT Fier është bërë nga ana Juaj, si edhe duke mbajtur parasysh se për këtë kategori ai nuk përfshin pagesën e taksave por vetëm të sigurimeve shoqërore.. Kjo pamundësi, nuk vjen as për fajin tim, dhe as për fajin e nënës time, e cila nuk kishte as arsye dhe as detyrim të ruante këtë dokumentacion, aq më tepër që tashmë ka përfunduar atë punë prej një kohe të gjatë dhe është në pension. Për sa më sipër, subjekti ka kërkuar nga KPK që të konkludohet, se ajo ndodhet në pamundësi për të provuar të ardhurat vetëpunësimi i nënës dhe të zbatohet neni 32/2 i Ligjit 84/2016, në këtë pikë dhe Komisioni të gjejë që prindërit e mi kanë patur të ardhura të mjaftueshme për të më dhënë huat, pa bërë një analizë financiare.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

19.61. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, dhe deklaratimet në seancat dëgjimore, arsyeton se:

i) Lidhur me saktësinë e deklaratimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën Vetting

19.62. Subjekti i rivlerësimit duke mos deklaruar huan e marrë nga prindërit në vlerën 5.000.000 lekë në vitin 2015, përdorur si burim krijimi për prenotimin e këtij apartamenti, ka vepruar në kundërshtim me nenin D, pikat 2 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës, neni 32, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe udhëzimi e ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, të cilët detyrojnë subjektin e rivlerësimit jo vetëm për deklarimin e “pasurisë” por edhe të “burimit” në momentin e krijimit të saj.

19.63. Në lidhje me pretendimin e subjektit se një detyrim i tillë për deklarimin e burimit në momentin e krijimit e kësaj pasurie në momentin e krijimit të saj, në vitin 2015 nuk ekziston i tillë në ligj dhe është edhe i pakuptimtë” vlerësohet nga trupi gjykues si një pretendim i papranueshëm, për sa kohë procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë i cili buron nga dispozitat kushtetuese dhe parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, përcakton në mënyrë të qartë detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për të deklaruar me saktësi, pasuritë në pronësi, posedim apo përdorim dhe burimet e krijimit të tyre, i cili konsiston në të ardhurat financiare që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie.

19.64. Kolegji i Posaçëm i Apelit në jurisprudencën e tij ka arsyetuar se: “Bazuar në nenin D, pikat 2 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës, neni 32, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, udhëzimi i ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e

rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit jo vetëm për deklarimin e “pasurisë” së tij, por edhe të “burimit” në momentin e krijimit të saj”.

19.65. Pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, qartazi përcakton detyrimin e subjekteve të rivlerësimit që të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave. Leximi i kësaj dispozite përjashton çdo debat mbi rëndësinë që ka deklarimi i saktë i pasurive në kuadër të vlerësimit të këtij kriteri.

19.66. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se ka pasaktësi në deklarimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* duke mos u deklaruar huaja e marrë nga prindërit në vlerën 5.000.000 lekë në vitin 2015 përdorur si burim krijimi për apartamentin.

ii) Lidhur me burimin e ligjshëm të huas deklaruar si burim krijimi

19.67. Kualifikimi i prindërve të subjektit të rivlerësimit si persona të tjerë të lidhur, sipas përkufizimit të dhënë në pikën 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, provohet nga lidhja e interesit pasuror mes tyre.

19.68. Lidhja e interesit pasuror është trajtuar në nenin 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet në mënyrë specifike se cilat marrëdhënie do të përfshihen në sferën e interesit pasuror, ku përfshihet dhe marrëdhënia e huamarrjes prej subjektit të rivlerësimit.

19.69. Duke qenë se personat e tjerë të lidhur (prindërit e subjektit), deklarohen si huadhënës dhe konfirmojnë marrëdhënien e huas, ata trajtohen brenda përcaktimit të nenit 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të dhëna hua.

19.70. Në zbatim të këtij kuadri ligjor, subjekti i rivlerësimit, dhe personat e tjerë të lidhur për efekt të procesit të rivlerësimit, detyrohen të provojnë burimin e ligjshëm të pasurisë së personit tjetër të lidhur, për pasurinë e përfshirë në marrëdhënien e konfirmuar të huas.

19.71. Trupi gjykues kreu një vlerësim të situatës faktike financiare të prindërve të subjektit në kohën e dhënies së huas, prej 5.000.000 lekë në vitin 2015, duke i ka ngarkuar subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e krijimit të vlerave monetare në pronësi të prindërve të tij, si një detyrim i parashikimeve ligjore sipërcituar.

19.72. Komisioni përgatiti analizën financiare për huadhënësit vitet 2004-2015, duke vlerësuar në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt, që garanton të drejtat e palës dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit e objektivitetit, të konsiderojë në analizën financiare, skenarin më favorizues dhe garantues për subjektin e rivlerësimit, nëpërmjet përfshirjes në këtë analizë edhe të vlerave monetare gjendje në bankë në vlerën 2.340.134 lekë (dokumentuar në datë 31.12.2003) dhe pa përfshirë në të pasuri, shpenzime të kryera nga huadhënësit huadhënësit si dhe gjithashtu janë llogaritur edhe interesa që mund ti takojnë vlerave monetare me burim të pajustificuar të ardhurash. Prindërit e subjektit pavaresisht kësaj llogaritje, nuk justifikonin dhënien e huasë për subjektin, vlerat monetare gjendje në llogaritë bankare, investimet në Bono Thesari në BSH, si dhe kryerjen e shpenzimeve për jetesë për periudhën 01.01.2004-31.12.2015 duke rezultuar me një balancë negative prej **-4.864.979** lekësh.

19.73. Subjekti i rivlerësimit, nuk ka provuar të kundërtën e barrës së proves mbi mundësinë e prindërve për krijimin e shumës 5.000.000 lekë për huanë dhënë subjektit për arsytet si vijon:

(i) Për të provuar faktin se nëna ka qenë tregtare ambulante, ka paraqitur deklaratat noteriale nga individë, të cilët deklarojnë se kanë ushtruar aktivitetin e ambulantit, si tregtarë ambulantë në tregun ambulant të qytetit të Lushnjës, në të njëjtën kohë me nënën e saj.

-Trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin si të ligjshme të të ardhurave të nënës si tregtare ambulante, arriti në përfundimin se nuk gjejnë

mbështetje në dokumentacion, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion zyrtar që provon ushtrimin e aktivitetit tregtar ambulant nga nëna, por është përpjekur të provojë këtë fakt me deklaratat noteriale të individëve, të cilët pretendohet se kanë ushtruar aktivitetin e ambulancës në të njëjtën kohë me nënën e saj.

-Deklaratat noteriale, në një qëndrim tejet garantist në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, mund të provojnë faktin se nëna ka zhvilluar aktivitet tregtar ambulant në periudhën e pretenduar, por nuk mund të provojnë kurrësi të ardhurat e përfituara nga ky aktivitet, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe ligjshmërinë e krijimit të tyre.

-Në këto kushte, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues të ardhurat e realizuara nga nëna e saj.

(ii) Lidhur me dietat nga babai i subjektit pretenduar për t'u marrë në konsideratë në analizën financiare për të provuar mundësinë e prindërve për krijimin e likuiditeteve bankare duke pasur parasysh natyrën e tyre, për të mbuluar shpenzime të kryera në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit, nuk mund të pretendohen se kanë shërbyer si burim të ardhurash.

(iii) Shpenzimet minimale për konsum llogaritur nga Komisioni për periudhën (2-4 persona) janë llogaritur sipas deklaratimeve të subjektit.

(iv) Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit si në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ashtu edhe në parashtesat më pas se ekzistenca e vlerave monetare në llogaritë bankare të prindërve që përpara fillimit të detyrës e në vazhdim kanë qenë të mjaftueshme për dhënien e huave, trupi gjykues vlerëson se, pasja ose jo e likuiditeteve në llogari bankare apo të investuara në bono thesari nuk janë fakte që legjitimojnë burimin e të ardhurave. Vlerësimi mbi legjitimitimin e burimit të pasurisë del si rezultat i hetimit administrativ të Komisionit dhe bëhet vetëm nëse plotësohen kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

(v) Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për pamundësi objektive sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se që subjekti të jetë në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër, dhe kjo nuk u arrit të provohet nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti nuk ka arritur të provojë sa më sipër.

(vi) Lidhur me të ardhurat e dokumentuara të babait të subjektit, reflektimi nga Komisioni të ardhurat në formën e pagesës së papunësisë nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit²⁵ për periudhën shkurt 2013-janar 2014, ajo nuk ndikon në konkluzionin përfundimtar në lidhje me mundësinë financiare nga burime të ligjshme të prindërve të subjektit për dhënien e huas në shumën 5.000.000 lekë, përdorur për pagesën e apartamentit.

(vii) Gjithashtu alternativa e propozuar nga subjekti i rivlerësimit Komisioni të gjejë që prindërit e saj kanë patur të ardhura të mjaftueshme për të më dhënë huatë, pa bërë një analizë financiare, bie ndesh jo vetëm me gjuhën e dispozitave që rregullojnë deklarinimin e pamjaftueshëm në Kushtetutë dhe ligj, por edhe me frymën e procesit të rivlerësimit.

19.74. Pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit për sa i përket huas në shumën 5,000,000 lek, Në konkluzion , trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 25.09.2020 (Drejtorja e Arkivit Tiranë kthim përgjigje z. H. B..

ligjshmërinë e huasë së marrë nga prindërit në vlerën 5.000.000 lek në vitin 2015 dhe ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, “b”, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

19.75. Komisioni arrin në konkluzionin se nuk duhen konsideruar këto të ardhura në analizën financiare për vlerësimin e mundësisë së krijimit të kësaj pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit.

iii) Lidhur me të ardhura nga qiratë, deklaruar si burim krijimi

19.76. Në deklaratën *Vetting*, në seksionin e të ardhurave, personi i lidhur ka deklaruar: “*Të ardhura nga qiraja me nr. *** pasuri, Tiranë, z. k. **, në shumën 19 454 euro*”, ndërsa në seksionin e pasurive të deklaratës *Vetting* personi i lidhur ka deklaruar: “*Apartament me sip. 90 m², Tiranë, z. k. ** fituar me cedim kontrate, sipas kontratës së vitit 2012 dhe i regjistruar në vitin 2015*”.

19.77. Trupi gjykues analizoi deklaratimet, ndër vite, të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur (bashkëshortit të saj), lidhur me deklarimin e pasurive dhe të ardhurave nga qiratë, deklaruar si burim krijimi për apartamentin me sip. 120.3 m², në Tiranë, nga ku rezultoi si vijon:

19.78. Subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike vjetore (përveçse në deklaratën *Vetting*), pasurinë e paluajtshme apartament me sip 90 m², me nr. **, z. k. **, Tiranë dhe as të drejtat reale mbi të sipas përcaktimit të Kodit Civil, si detyrim i subjektit për deklarim, bazuar në nenin 4, pg. 1, pika a), të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive” i ndryshuar.

19.79. Në DPV-në 2009, personi i lidhur ka deklaruar: “*Llogari bankare nr. ** në “Intesa Sanpaolo Bank”, shtesa në këtë llogari vjen nga qiraja e një ap 1+1 i cili nuk ka kaluar në pronësi të deklaruesit shuma 6,791 euro*”, pjesa takuese e qirasë është vetëm 2.100 euro.

19.80. Në DPV-në 2010, personi i lidhur ka deklaruar: “*Llogari bankare nr. ** në Intesa Sanpaolo Bank (të ardhura nga qiraja). Shuma 2917,98 euro*”.

Në DPV-në 2011, personi i lidhur ka deklaruar: “*Llogari bankare nr. ** në Intesa Sanpaolo Bank (të ardhura nga qiraja). Shuma 2350 euro*”.

Në DPV-në 2013, subjekti ka deklaruar tek seksioni i të ardhurave: “*Të ardhura nga qiraja ap. 1+1 deklaruar më parë: rruga **, Tiranë. Shuma 945 euro*”.

Në DPV-në 2014, subjekti ka deklaruar te seksioni i të ardhurave: “*Të ardhura nga qiraja ap. 1+1 deklaruar më parë: rruga **, Tiranë. Shuma 3793 euro*”.

Në DPV-në 2015, subjekti ka deklaruar te seksioni i të ardhurave: “*Të ardhura nga qiraja ap. 1+1 deklaruar më parë: **, Tiranë. Shuma 4190 euro*”.

Në DPV-në 2016, subjekti ka deklaruar tek seksioni i të ardhurave: “*Të ardhura nga qiraja ap. 1+1 deklaruar më parë: Rruga **, Tiranë. Shuma 4400 euro*”.

19.81. Për të provuar të drejtat reale mbi pasurinë apartament, subjekti ka depozituar në ILDKPKI, aktmarrëveshje për cedim kontrate nr. **, datë 17.12.2012, deklaratë noteriale nr. **, datë 24.7.2015 dhe deklaratë noteriale nr. **, datë 24.7.2015, certifikatë pronësie, e pasurisë apartament **, me sip. 90 m², ku te seksionin e regjistrimit të pronësisë është shënuar aktmarrëveshja për cedim kontrate e datës 17.12.2012. Në seksionin e kufizimeve është shënuar: “*VKKP ** truall në përdorim qeradhënësi S. P. i jep të drejtën qeramarrësisit Ll. A., të ndërtojë cdo lloj ndërtimi dhe qeradhënësi merr obligimin të paguaje vleftën e ndërtimit+20% mbi këtë vlerë në përfundim të kësaj kontrate*”.

19.82. Komisioni administroi shkresën nga ASHK në të cilën vërtetohej se apartamenti me sip. 90 m², ishte regjistruar në pronësi të personit të lidhur.

19.83. Aktmarrëveshja për cedim kontrate nr. ***, datë 17.12.2012, me palë M. A., P. A., K. V., A. B., E. A., H. A., O. A. dhe personit të lidhur/E. H. referonte sa më poshtë: *“Trashëgimlënesi i z. E. H., av. E. H. për disa vite ka përfaqësuar interesat e trashëgimtarëve të familjes A. në disa procese gjyqësore civile në lidhje me këtë konflikt. Për efekt të këtyre shërbimeve dhe marrëdhënieve miqësore, ka qenë marrëveshje midis palëve që të drejtat e trashëgimtarëve A. të familjes A. në lidhje me një apartament nga ata të treguar më lart ti kalonin të ndjerit av. E. H.. Trashëgimtarët e familjes A., i kalojnë / cedojnë z. E. H. të gjitha të drejtat e fituara prej tyre në sajë të kontratës nr. ***, datë 25.10.1997, në lidhje me një apartament prej 92 m², ndodhur në katin e shtatë të ndërtesës të ngritur sipas kontratës nr. ***, datë 25.10.1997... palët pranojnë se ky apartament i është vënë në posedim z. E. H. që prej 1.3.2009...”*.

19.84. Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.7.2015, citohej: *“bashkëpronarët e familjes A. do të përfitonin disa apartamente banimi në bazë të marrëveshjes nr. ***, datë 25.10.1997; kontratës së dhurimit nr. ***, datë 18.12.1998, lejes së ndërtimit të dhënë nga KKRRT e Bashkisë Tiranë me vendimin ***, datë 21.02.1998; si dhe projektit të zbatuar “****” deklarohet se shoqëria *** ka marrë përsipër detyrimet dhe të drejtat që i kanë lindur shoqërisë *** Shpk, në lidhje me përmbushjen e kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 25.10.1997. Sa më sipër, në zbatim të këtyre akteve dhe në përmbushje të detyrimeve të parashikuara prej tyre, në përfundim të ndërtimit të objektit shoqëria *** sh.p.k. i ka dorëzuar bashkëpronarëve të familjes A. pasuritë e paluajtshme që do të përfitoheshin prej tyre nga ndërtimi i objektit. Në pikën rendore nr. 11 të listës së pasurive citohet: “...apartament 2+1, kati ***, nr. ***, z. k. ***, nr. ***, pasurie, vol. ***, f. ***...”*.

19.85. Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.7.2015, citohen të njëjtat të drejta dhe detyrime si në deklaratën nr. ***, datë 24.7.2015: *“Trashëgimtarët e Ll. A., bashkëpronarët e familjes A., me vullnetin e tyre të lirëdeklaruan se: kemi marrë në dorëzim nga shoqëria “****” sh.p.k. pasuritë e ndara respektivisht ndërmjet nesh si më poshtë. Po kështu, nga këto pasuri i kemi dorëzuar z. E. H. apartamentin e treguar më poshtë: E. H., ap. 2+1, kati ***, nr. ***, z. k. *** nr. ***, pasurie, vol. ***, f. ***”*.

19.86. Bashkëpronarët e familjes A. deklarorin se marrin përsipër dhe do ta ruajnë të padëmtuar shoqërinë “****” sh.p.k., duke e shkarkuar nga çdo përgjegjësi të kërkuar nga palë të treta, në lidhje me pasuritë e mësipërme dhe në lidhje me çdo konflikt gjyqësor aktual apo të mëpasshëm me objekt truallin nën-godinë apo këto apartamente dhe garazhe dhe në mënyrë të veçantë bashkëpronarët e familjes A., marrin përgjegjësi për gjykimin që po bëhet me palë P. H., M. H., V. H. dhe K. P..

19.87. Komisioni konstatoi se aktmarrëveshja për cedim të drejtash e lidhur midis familjes A. dhe personit të lidhur me subjektin (bashkëshortin) në vitin 2012 kishte në objekt rregullimin me efekt prapaveprues të kalimit të të drejtave sipas kontratës nr. ***, datë 25.10.1997, të një apartamenti me sip. 92 m², ndodhur në katin e shtatë mbi truallin e ndodhur në kryqëzimin e rruga “****” dhe rruga “****” dhe rregullimin me efekt prapaveprues të tagrave të posedimit dhe gëzimit të tij nga personi i lidhur me subjektin.

19.88. Nga përmbajtja e kësaj marrëveshje, familjarët A., i kanë ceduar të drejta personit të lidhur, kur kanë pasur vetë vetëm tagrin e përdorimit mbi truallin me sip. 1035 m² mbi të cilin është ngritur ndërtimi sipas kontratës së sipërmarrjes të cituar në këtë marrëveshje.

19.89. Sipas kësaj marrëveshje, rezulton se lidhur me truallin dhe ndërtesën e ngritur mbi të familjarët A. kanë pasur një konflikt gjyqësor me trashëgimtarët e S. P. lidhur me pronësinë

mbi to dhe kalimi i të drejtave sipas kësaj marrëveshje ishte parashikuar me kusht, i cili ishte përcaktuar se në rast se familja A. nuk arrinte të fitojë pronësinë ose humbiste posedimin, mbi apartamentet, të njëjtin fat kishte edhe apartamenti objekt i kësaj marrëveshje.

19.90. Deklaratat noteriale të lëshuara në të njëjtin datë (më 24.7.2015) nga administratori i shoqërisë sipërmarrëse²⁶ “***” sh.p.k., kanë rregulluar me efekt prapaveprues dorëzimin e apartamenteve familjarëve A., duke specifikuar, ndër të tjera, edhe apartamentin e dorëzuar personit të lidhur me subjektin.

19.91. Në analizë të dispozitave ligjore, sipas të cilave titulli i pronësisë kërkon të pasurit kumulativisht të tagrit të gëzimit dhe disponimit lirisht të sendeve, dhe referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni, trupi gjykues vlerësoi se trashëgimtarët e familjes A., të cilët i kanë kaluar të drejta personit të lidhur me subjektin, nuk duken të kenë patur tagra për të gëzuar dhe disponuar lirisht truallin dhe pallatin mbi të, për shkak të konflikteve gjyqësore të pronësisë me trashëgimtarët e S. P..

19.92. Trashëgimtarët e familjes A. kanë pasur vetëm të drejta përdorimi mbi truallin mbi të cilën është ndërtuar pallati, dhe nuk provohet të kenë patur tagra gëzimi lirisht të apartamentit të cilën ia kanë kaluar personit të lidhur.

19.93. Sa më sipër nuk provohet fitimi i të drejtave të pronësisë nga personi i lidhur në një nga mënyrat ligjore të fitimit të pronësisë sipas nenit 163 e vijues i Kodit Civil, dhe për rrjedhojë, gëzimi e këtij apartamenti dhe frytet e tij (të ardhurat nga qiraja) nuk provohen të kenë ardhur nga një burim i ligjshëm, për sa personi i lidhur nuk kishte vetë tagra ligjorë mbi apartamentin.

19.94. Kodi Civil nuk parashikon lidhjen e marrëdhënieve të ligjshme me efekt prapaveprues, përveçse rasteve të zgjidhjes së kontratës për mospërmbushje të detyrimeve sipas nenit 703 të Kodit Civil. Aktmarrëveshja për cedim kontrate e vitit 2012, për pasojë nuk ka sjellë pasoja ligjore për sa rregulloi me efekt prapaveprues marrëdhëniet e mëparshme (qira nga viti 2009).

19.95. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, subjektit të rivlerësimit me qëllim të paraqitjes së shpjegimeve dhe provave për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit, lidhur me sa duket se:

i) Nuk janë deklaruar të drejtat reale të personit të lidhur mbi pronësinë e pasurisë apartament në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, të drejtat që kanë lindur nga aktmarrëveshja për cedim kontrate në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 si dhe pronësia mbi apartamentin në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015.

ii) Në lidhje me gëzimin e këtij apartamenti dhe frytet e saj (të ardhura nga qiraja) nuk provohet burimi i ligjshëm i këtyre të ardhurave për sa personi i lidhur nuk kishte vetë tagra ligjorë ta jepte me qira apartamentin, dhe për sa duket se personi i lidhur me subjektin nuk e ka përfituar apartamentin në asnjë nga mënyrat ligjore të fitimit të pronësisë dhe as të ketë pasur tagra posedimi dhe gëzimi të ligjshme mbi atë pasuri.

iii) Aktmarrëveshja për cedim kontrate e vitit 2012 nuk duket të ketë sjellë pasoja ligjore me efekt prapaveprues edhe mbi marrëdhëniet e mëparshme (qiratë nga viti 2009), për sa Kodi Civil nuk parashikon lidhjen e marrëdhënieve me efekt prapaveprues, përveçse rasteve të zgjidhjes së kontratës për mospërmbushje të detyrimeve sipas nenit 703 të Kodit Civil.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

19.96. *“Në lidhje me gjendjen e faktit, apartamenti në fjalë ju dorëzua fizikisht personit të lidhur në mars 2009. Në atë moment nuk qe e mundur të mbahej një akt për cedimin e të*

²⁶ E cila sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., ka marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet që i kanë lindur shoqërisë “***” sh.p.k., në lidhje me kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.10.1997.

*drejtave që trashëgimtarët e familjes A. kishin fituar nga kontrata me shoqërinë ***, për shkak se ata kishin mosmarrëveshje mes njëri tjetrit në lidhje me pjesët takuese në ndërtesën e ngritur nga *** shpk dhe një pjesë e tyre jetonin jashtë Shqipërisë.*

*Kjo gjë u bë e mundur në vitin 2012 dhe personit të lidhur ju ceduan të drejtat e kontratës që trashëgimtarët A. kishin me shoqërinë ***. Ajo marrëveshje për cedim kontrate (nr. ***, datë 17.12.2012) synonte të pasqyroste me shkresë situatën e faktit që palët kishin stabilizuar më parë në formë verbale. Formulimi që në atë marrëveshje palët i janë referuar faktit se prej vitit 2009 ky apartament i ishte dorëzuar prej tyre dhe dhënë me qira të tretëve nga personi i lidhur, (bashkëshorti z. E. H.), u bë për arsye që nga trashëgimtarët A., të mos kishte në të ardhmen pretendim për përdorimin që personi i lidhur i kishte bërë apartamentit gjatë kësaj periudhe duke i vjelë frutat (qiranë).*

*Kjo marrëveshje ishte premisa që më pas shoqëria *** këtë pasuri t'ja kalonte përfundimisht në pronësi në vitin 2015, personit të lidhur, pasi me anë të kësaj marrëveshje ai fitonte të drejtat që trashëgimtarët A. kishin ndaj shoqërisë *** shpk, në raport me këtë apartament.*

*Apartamentin në fjalë e kam deklaruar që në DPV 2009. Edhe pse situata juridikisht nuk ishte shumë e qartë për të gjithë faktorët që shpjegohen këtu, duke qenë se nuk ishte formalizuar veprimi juridik për kalimin e të drejtave të kontratës së sipërmarrjes që trashëgimtarët A. kishin me shoqërinë ***, tek personi i lidhur, kam menduar se duke qenë se ky apartament ju dorëzua materialisht personit të lidhur, në vitin 2009 dhe ai u dha me qira, duhej të deklarohet se kisha interesa në këtë apartament dhe se merrja qiranë prej tij.”*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

19.97. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*”; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, dhe deklaratimet në seancat dëgjimore arsyeton se:

(i) Neni 144 i Kodit Civil parashikon se: “Sendet e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi të regjistruhen në regjistrat e pasurive të paluajtshme”.

(ii) Titullari i të drejtës së pronësisë, ka në të njëjtën kohë edhe tagrin e përfitimit të fryteve civile dhe natyrore të sendit, si qiraja nga dhënia me qira e pronës së paluajtshme – fryte civile.

(iii) Pronësia dhe posedimi janë gjendje juridike të ndryshme nga njëra-tjetra. Ndërsa pronësia përfaqëson një situatë juridike mbi sendin, posedimi përfaqëson situatën reale dhe faktike të subjektit mbi sendin.

(iv) Posedimi është pikërisht sundimi dhe pushteti efektiv, faktik mbi sendin. Ligjërisht pronari është dhe duhet të jetë dhe posedues faktik mbi sendin. Ai sundon sendin efektivisht dhe faktikisht por mund të ndodhë që poseduesi i sendit nuk është pronar i tij . Referuar të drejtës sonë civile **posedimi është një e drejtë që mund të ushtrohet dhe nga personi, i cili nuk është pronar i sendit, por ka të drejtën e posedimit të tij në bazë të një marrëveshje me pronarin**, (si marrëveshje qiraje, uzufukt, emfiteoze etj. ose posedon sendin në bazë të një akti administrativ).

(v) Në analizë të dispozitave ligjore, titulli i pronësisë kërkon të pasurit kumulativisht të tagrit të gëzimit dhe disponimit lirisht të sendeve.

19.98. Referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni, trashëgimtarët e familjes A. të cilët i kanë kaluar të drejta personit të lidhur me subjektin, nuk duken të kenë patur tagra për

të gëzuar dhe disponuar lirisht truallin dhe pallatin mbi të, për shkak të konflikteve gjyqësore të pronësisë me trashëgimtarët e S. P..

19.99. Per sa trashëgimtarët e familjes A. kanë pasur vetëm të drejta përdorimi mbi truallin mbi të cilën është ndërtuar pallati, dhe nuk provohet se kanë patur tagra gëzimi lirisht të apartamentit të cilën ia kanë kaluar personit të lidhur, nuk provohet fitimi i të drejtave të pronësisë nga personi i lidhur në një nga mënyrat ligjore të fitimit të pronësisë sipas nenit 163 e vijues i Kodit Civil.

Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se për të ardhurat nga qiraja, deklaruar si burim krijimi subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e krijimit të tyre.

19.100. Në përfundim, lidhur me **apartament banimi me sipërfaqe 120.3 m²**, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

-Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, **për apartament banimi me sipërfaqe 120.3 m²**, duke mos deklaruar huan e marrë nga prindërit e saj në vlerën 5.000.000 lekë në vitin 2015, si burim krijimi dhe vendos subjektin në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 dhe e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, gërma “a” dhe 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

-Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë së dhënë hua, nga prinderit në vlerën 5.000.000 lek, si dhe ligjshmërinë e të ardhurave nga qiratë Komisioni arrin në konkluzionin se nuk duhen konsideruar këto të ardhura në analizën financiare për vlerësimin e mundësisë së krijimit të kësaj pasurie, dhe kjo passjell mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri, nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke mos arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me pamundësinë financiare për krijimin e tij.

-Për rrjedhojë trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, **apartament banimi me sipërfaqe 120.3 m²**, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

20. Automjeti “Ford Kuga”,

20.1.Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur ka deklaruar: “*makina Ford KUGA blerë në vitin 2010 nga ***, çmimi: 23,900 euro*”. Në deklaratën *Vetting* nuk është deklaruar burimi i krijimit të automjetit “Ford Kuga”, në vlerën 23.900 euro.

20. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, personi i lidhur ka deklaruar: “*Blerje autoveture tip ‘Ford KUGA’, në vlerën 23.900 euro, me burim: 8.140 euro kursime nga llogaria bankare në Intesa Sanpolo, 2.160 euro kursime nga shitja e automjetit ‘Mercedez-Benz’, 600 euro kursime nga të ardhurat, dhe 13.000 euro ose 1.800.000 lekë hua*”.

20.3.Në seksionin “Detyrime financiare”, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, personi i lidhur ka deklaruar: “*Hua pa interes për blerje makine në shumën 1.800.000 lekë, për një periudhë 5 vjeçare nga H. B., babai i deklarueses*”. *Shuma e shlyer deri në 31 dhjetor 300.000 lekë, gjendja e detyrimit 1.500.000 lekë*”.

20.4. Komisioni administroi faturën tatimore të shitjes së automjetit me nr. ***, datë 26.2.2010, lëshuar nga pala shitëse “****” me çmim 23.900 euro.

Analiza e burimit të krijimit

Hua nga babai i subjektit në shumën 13.000 euro (1.800.000 lekë)

20.5. Subjekti ka deklaruar në DPV/2010 se për këtë investim ka përdorur edhe huan në shumën 13.000 euro nga prindërit e saj, ndërsa në deklaratën *Vetting* nuk e ka deklaruar huan si burim për krijimin e pasurisë.

20.6 Komisioni²⁷ i ka kërkuar subjektit të shpjegojë shkakun e mosdeklarimit të kësaj huaje si burim i të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, si dhe paraqitjen e dokumentacionit përkatës ligjor mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave për huan, bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

20.7. Në vijim, subjekti shpjegoi se: *“Në lidhje me kohën e marrjes dhe kthimit të huas prej 18 milion lekësh për blerjen e pasurisë automjet tip ‘Ford Kuga’, me targa ***, huaja është marrë përpara kryerjes së porosisë së automjetit, që duhet të këtë qenë me sa kujtoj, fundi i muajit janar 2010.*

20.8. *Në lidhje me mundësinë financiare të babait dhe nënës time për dhënien e kësaj huaje, ashtu siç është deklaruar në deklaratën e vitit 2003, vit në të cilin filloi edhe deklarimi i pasurisë dhe përputhet gjithashtu edhe me fillimin e detyrës time si gjyqtare, nëna dhe babai im kanë patur kursime në Bankën e Shqipërisë të investuara në bono thesari në shumën 2,7 milion lekë, sipas deklarimeve, shumë e cila që në atë kohë tejkalonte shumën e dhënë hua në vitin 2010. Siç mund të verifikohet nga lëvizjet e tyre të llogarive shuma e dhënë hua, jo vetëm është kthyer por edhe gjendet edhe sot pas 10 vitesh në llogaritë e tyre”.*

20.9. Komisioni përgatiti analizën financiare, në ditën e blerjes së automjetit më 26.2.2010, sipas faturës tatimore të lëshuar nga shitësi në këtë datë, nga ku rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të investuar në këtë pasuri të luajtshme, në datën 26.2.2010.

20.10. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit, lidhur me sa duket se:

i) ka mospërputhje midis deklaratës *Vetting* dhe deklarimit periodik në lidhje me burimet e krijimit të kësaj pasurie, si dhe ka mosdeklarim të huas në shumën 1,800,000 lekë si burim krijimi i automjetit “Ford Kuga” në deklaratën *Vetting*;

ii) subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të investuar në pasurine automjet, në datën 26.02.2010, duke mos marrë në konsideratë huan nga prindërit.

20.11. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e mësipërme nga subjekti i rivlerësimit dhe dëgjoi atë në seance duke vlerësuar respektimin e parimit të barazisë së armëve dhe duke mbajtur parasysh të respektojë të drejtat e subjektit të rivlerësimit në këtë proces për të mos lejuar që ajo të vendoset në një gjendje të pafavorshme për shkak të mungesës për të marrë informacion apo mësuar mbi fakte që nevojiten për mbrojtjen e saj efektive, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave, *ex officio*, për të parandaluar çdo disavantazh, vlerësoi t’i japë shpjegimet shtesë lidhur me këtë huamarrje në vitin 2010 si vijon:

20.13. Në vlerësim të faktit se si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe personat e tjerë të lidhur të deklaruar në cilësinë e huadhënësit ose huamarrësit, pasi kanë konfirmuar këtë marrëdhënie, referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre pasurive, likuiditete të dhëna hua.

20.14. Pra, huadhënësit e vetëdeklaruar (prindërit e subjektit), së bashku me subjektin e rivlerësimit kishin detyrimin ligjor dhe kushtetues që gjatë procesit të rivlerësimit të justifikonin dhe të argumentonin me dokumente shoqëruese ligjshmërinë e burimit të krijimit

²⁷ Pyetësor nr. II

të kësaj pasurie, pjesë e çmimit të blerjes së automjetit tip “Ford”, në vitin 2010, nga bashkëshorti i subjektit.

20.15. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, personi i lidhur (në deklarin e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, në detyrime financiare si dhe në të dhëna konfidenciale) ka deklaruar huan e marrë nga babai i subjektit në shumën 1.800.000 lekë, si pjesë e burimit të të ardhurave për blerjen e automjetit.

20.16. Subjekti i rivlerësimit që në pjesën “Deklarimi i pasurisë” ka pasur detyrim ligjor të deklaronte në deklaratën e pasurisë *Vetting* jo vetëm pasurinë autoveturë tip “Ford Kugapor edhe burimet të cilat kanë shërbyer për krijimin e saj, në vitin 2010.

20.17. Në analizë të dokumentacionit të administruar nga Komisioni²⁸, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni kreu analizë financiare për periudhën 1.1.2004 – 31.12.2010, për të evidentuar mundësinë financiare të prindërve për krijimin e vlerave monetare në shumën 1.500.000 lekë²⁹ dhënë hua subjektit kryerjen e shpenzimeve minimale për konsum, si dhe shtimin e vlerave monetare në llogari bankare, konkretisht:

Analiza financiare periudha 1.1.2004 - 31.12.2010	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Gjendje në <i>cash</i> në datën 31.12.2003	0
Vlera monetare në bankë gjendje në datë 31.12.2003 (BSh investim në B. Thesari)	2.340.134
Total vlera monetare dokumentuar në datë 31.12.2003 (1)	2.340.134
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat dhe shpërblimet babai i subjektit për periudhën	2.571.462
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat dhe shpërblimet nëna e subjektit për periudhën	0
Të ardhura nga aktiviteti tregtar, nëna e subjektit	0
Të ardhura nga interesat	2.461.050
Total të ardhura /të hyra financiare (2)	5.032.512
Hua dhënë bashkëshortit të subjektit shuma 1.800.000 lekë (mbetur pa kthyer shuma 1.500.000 lekë në datën 31.12.2010)	1.500.000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën (2-4 persona)	2.701.004
Total shpenzime/të dala financiare (3)	4.201.004
Gjendje në <i>cash</i> në datën 31.12.2010	0
Vlera monetare në bankë dokumentuar gjendje në datën 31.12.2010	6.600.176
Total vlera monetare dokumentuar në datën 31.12.2010 (4)	6.600.176
Balanca e fondeve (1+2-3-4)	-3.428.534

20.18. Për sa më sipër, prindërit e subjektit duket se nuk justifikojnë dhënien e huas për bashkëshortin e subjektit, vlerat monetare gjendje në llogaritë bankare, investimet në Bono

²⁸ Përfshirë dhe jo vetëm: (i) të ardhura të babait të subjektit referuar Raiffeisen Bank në shumën 2.571.462 lekë për periudhën 2005-31.12.2010; (ii) Investuar në Bono Thesari në datë 31.12.2003, prindërit në shumën 2.340.134 lekë dhe në datë 31.12.2010 në gjendje 5.510.000 lekë, referuar të dhënave nga BSH; (iii) Gjendje në BKT në llogari të nënës në shumën 1.06.517 lekë në datë 31.12.2010 ; (iv) gjendje në Raiffeisen Bank në llogari të babait shuma 29.659 lekë në datë 31.12.2010; (v) Për periudhën 01.01.2004-31.12.2010, shpenzimet për jetesë janë llogaritur në dy grupime: 2004-qershor 2008 për 4 persona dhe korrik 2008-31.12.2010 për 2 persona. bazuar në dokumentacionin e disponuar si dhe deklarin e subjektit në pyetësor nr.1.

²⁹ Referuar deklarin në DPV/2010, se shuma e mbetur e huas në datën 31.12.2010 ka qenë 1.500.000 lekë

Thesari në Bankën e Shqipërisë, si dhe kryerjen e shpenzimeve për jetesë për periudhën 1.1.2004 – 31.12.2010.

Në analizën financiare nuk janë përfshirë pasuri, shpenzime të kryera nga huadhënësit huadhënësit, gjithashtu, janë llogaritur edhe interesa që mund t'i takojnë vlerave monetare me burim të pajustificuar të ardhurash.

20.19. Qëndrimi subjektiv të rivlerësimit në lidhje me shpjegimet shtesë nga Komisioni është paraqitur dhe analizuar për pasurinë apartament me sip. 120.3 m², në Tiranë

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

20.20. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektivit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, dhe deklaratimet në seancat dëgjimore arsyeton se:

i) Lidhur me saktësinë e deklaratimit të subjektivit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

20.21. Trupi gjykues vlerëson se sipas pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, “pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektivit të rivlerësimit.

20.22. Sipas pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaratimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

20.23. Formulari i deklaratimit të pasurisë për rivlerësimin – shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016 – vendos detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për deklarin dhe të gjitha pasurive të akumuluar ndër vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

20.24. Në zbatim të legjisllacionit të sipërcituar, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin që në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit të deklaronte pasuritë, si dhe burimet e krijimit të tyre.

20.25. Bashkëshorti i subjektivit nuk ka deklaruar burimin fillestar financiar, në kuptimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kesaj pasurie dhe as huan e përdorur si burim krijimi.

20.25.1. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shkelur detyrimin kushtetues dhe ligjor të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30, 31, pika 1, 32, pika 1 dhe shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave ajo ka detyrimin të dorëzojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin, me qëllim që t'i nënshtrohet kontrollit të pasurisë, për të verifikuar nëse i ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur.

20.26. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi bashkëshorti i saj në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të këtij automjeti në pronësi të tij dhe huan e përdorur si burim krijimi.

ii) Lidhur me hua në vlerën 1.800.000 lekë përdorur si burim krijimi

20.27. Trupi gjykues kreu një vlerësim të situatës faktike financiare të prindërve të subjektit në vitin 2010, kohë e dhënies së huas, në raport me legjislacionin e zbatueshëm, dhe në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë status, duke i ngarkuar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar ligjshmërinë e krijimit të vlerës monetare 1.800.000 lekë përdorur si burim krijimi i pasurisë, si një detyrim i parashikimeve ligjore.

20.28. Sa më sipër trupi gjykues vlerëson të nënvizojë se deri në datë 31.12.2010, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2003, prindërit e subjektit kanë shtuar pasurinë e tyre në likuiditete në bankë dhe dhëna hua, në vlerë **5.730.383 lekë** dhe këtu nuk janë përfshirë këtu pasuritë, vlerat monetare etj, të krijuara përpara se subjekti të fillonte detyrën në tetor të vitit 2003³⁰ dhe pasuri të tjera të paluajtshme dhe të luajtshme të krijuara për periudhën 2003-2010.

20.29. Komisioni përgatiti analizën financiare për huadhënësit vitet 2003-2010, duke vlerësuar në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt, që garanton të drejtat e palës dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit e objektivitetit, të konsiderojë në analizën financiare, skenarin më favorizues dhe garantues për subjektin e rivlerësimit, nëpërmjet përfshirjes në këtë analizë edhe të vlerave monetare gjendje në bankë në vlerën 2.340.134 lek (dokumentuar në datë 31.12.2003) dhe nuk përfshiu në të pasuri, shpenzime të kryera nga huadhënësit huadhënësit si dhe gjithashtu janë llogaritur edhe interesat që mund ti takojnë vlerave monetare me burim të pajustificuar të ardhurash. Prindërit e subjektit pavaresisht kesaj llogaritje perseri nuk justifikonin dhënien e huasë për bashkëshortin, vlerat monetare gjendje në llogaritë bankare, investimet në Bono Thesari në BSH, si dhe kryerjen e shpenzimeve për jetesë për periudhën 01.01.2004-31.12.2010 duke rezultuar me një balance negative prej -3.428.534 lekesh.

20.30. Subjekti i rivlerësimit, nuk ka provuar të kundërtën e barrës së provës mbi mundësinë e prindërve për krijimin e shumës 1.800.000 lek për huanë dhënë bashkëshortit të subjektit për arsye si vijon:

(i) Për të provuar faktin se nëna ka qenë tregtare ambulante, ka paraqitur deklaratat noteriale nga individë, të cilët deklarojnë se kanë ushtruar aktivitetin e ambulantit, si tregtarë ambulantë në tregun ambulant të qytetit të Lushnjës, në të njëjtën kohë me nënën e saj.

-Trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin si të ligjshme të të ardhurave të nënës si tregtare ambulante, arriti në përfundimin se nuk gjejnë mbështetje në dokumentacion, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion zyrtar që provon ushtrimin e aktivitetit tregtar ambulant nga nëna, por është përpjekur të provojë këtë fakt me deklaratat noteriale të individëve, të cilët pretendohet se kanë ushtruar aktivitetin e ambulantit në të njëjtën kohë me nënën e saj.

³⁰ Në deklaratën për herë të parë në datë 19.03.2004, plotësuar si gjyqtare në rrethin Gjyqësor Tiranë, subjekti i rivlerësimit, deklaroi përbërje familjare 4 persona (prindërit bashkë me dy motra), përveç deklaruesit.

Gjithashtu në pasuri të regjistruara më vete nga pjesëtarët e familjes dhe personat e tjerë të lidhur, babai i subjektit ka deklaruar:

-Apartament 2+1 me sip. 72.5 m², i ndodhur në ****, pallati i *** nr.*** Ap.*** Tiranë, regjistruar në hipotekë në datë 15.08.2003, me burim të deklaruar: i-shitje të ap. në Lushnjë; ii-kursime personale;

-Automjet tip benz 240 me targë *** në vlerë 500.000 lekë, pa burim të deklaruar;

Në aksione, letra me vlerë, pjesë në kapitale prindërit deklarojnë: i-pjesë kapitali të shoqërisë **** "Lushnjë në sasi 0.22%(pa informacion në vlerë) me vendndodhje ish SMT-ja Lushnjë, me burim :-nga privatizimi si ish punëtor i ndërmarrjes SMT; ii-letra me vlerë në formën e Bonove të Privatizimit në shumën 135.000 lekë me burim :-dhënë nga shteti;

Në likuiditete, prindërit deklarojnë :-Bono thesari në vlerë 2.700.000 lekë në Bankën e Shqipërisë, me burim :-të ardhura nga kursimet.

-Deklaratat noteriale, në një qëndrim tejet garantist në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, mund të provojnë faktin se nëna ka zhvilluar aktivitet tregtar ambulant në periudhën e pretenduar, por nuk mund të provojnë kurrsesi të ardhurat e përfituara nga ky aktivitet, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe ligjshmërinë e krijimit të tyre.

-Në këto kushte, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues të ardhurat e realizuara nga nëna e saj.

(ii)Lidhur me dietat nga babai i subjektit pretenduar për t'u marrë në konsideratë në analizën financiare për të provuar mundësinë e prindërve për krijimin e likuiditeteve bankare duke pasur parasysh natyrën e tyre, për të mbuluar shpenzime të kryera në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit, nuk mund të pretendohen se kanë shërbyer si burim të ardhurash.

(iii) Shpenzimet minimale për konsum llogaritur nga Komisioni për periudhën (2-4 persona) janë kryer sipas deklarimeve të subjektit, gjatë pyetësorëve.

(iv)Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit si në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ashtu edhe në parashtesat më pas se ekzistenca e vlerave monetare në llogaritë bankare të prindërve që përpara fillimit të detyrës e në vazhdim kanë qenë të mjaftueshme për dhënien e huave, trupi gjykues vlerëson se, pasja ose jo e likuiditeteve në llogari bankare apo të investuara në bono thesari nuk janë fakte që legjitimojnë burimin e të ardhurave.

Vlerësimi mbi legjitimitimin e burimit të pasurisë del si rezultat i hetimit administrativ të Komisionit dhe bëhet vetëm nëse plotësohen kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

(v) Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për pamundësi objektive sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se që subjekti të jetë në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër, dhe kjo nuk u arrit të provohej nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti nuk ka arritur të provojë sa më sipër.

(vi) Lidhur me të ardhurat e dokumentuara të babait të subjektit, reflektimi nga Komisioni të ardhurat në formën e pagesës së papunësisë nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit ³¹për periudhën shkurt 2013-janar 2014, ajo nuk ndikon në konkluzionin përfundimtar në lidhje me mundësinë financiare nga burime të ligjshme të prindërve të subjektit për dhënien e huas në shumën 1.800.000 lekë, përdorur për pagesën e automjetit.

(vii) Gjithashtu alternativa e propozuar nga subjekti i rivlerësimit Komisioni të gjejë që prindërit e saj kanë patur të ardhura të mjaftueshme për të më dhënë huatë, pa bërë një analizë financiare, bie ndesh jo vetëm me gjuhën e dispozitave që rregullojnë deklarinimin e pamjaftueshëm në Kushtetutë dhe ligj, por edhe me frymën e procesit të rivlerësimit.

20.31.Pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit për sa i përket **huas në shumën 1.800.000 lek**, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë me dokumentacion ligjor provues mundësinë financiare të huadhënësve për të krijuar të ardhurat e përdorura për këtë hua, duke mos provuar se për to ishin paguar detyrimet tatimore, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 25.09.2020 (Drejtorja e Arkivit Tiranë kthim përgjigje z. H. B..

Komisioni arrin në konkluzionin se nuk duhen konsideruar këto të ardhura në analizën financiare për vlerësimin e mundësisë së krijimit të kësaj pasurie nga ana e bashkëshortit subjektit të rivlerësimit.

20.32. Në përfundim, lidhur **automjet “Ford Kuga”**, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

-Bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar burimin fillestar financiar, në kuptimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kesaj pasurie duke mos deklaruar as huan e marrë nga prindërit e bashkëshortes, dhe për këtë arsye, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi bashkëshorti i saj në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të këtij automjeti në pronësi të tij.

Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë së dhënë hua, nga prindërit në vlerën 1.800.000 lek, Komisioni arrin në konkluzionin se nuk duhen konsideruar këto të ardhura në analizën financiare për vlerësimin e mundësisë së krijimit të kësaj pasurie, automjet dhe kjo passjell mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri, nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke mos arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me pamundësinë financiare për krijimin e këtij automjeti.

-Për rrjedhojë trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, **e luajtshme automjet “Ford Kuga”**, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për sa nuk arriti të provojë ligjshmërinë e të ardhurave prej 1.800.000 lek marra hua nga prindërit në vitin 2010 përdorur si burim krijimi për këtë pasuri.

21. Konflikti i interesit

21.1 Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit lidhur me sa referuar ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, pika 2 e nenit 24, “konflikti i interesave”, ILDKPKI-ja kishte konstatuar në raportin e saj se avokati i shtetit nuk mund të ushtrojë detyrën pranë zyrës vendore, nën juridiksionin e së cilës ushtrojnë profesionin e gjyqtarit, prokurorit ose të avokatit bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, vëllai, motra ose prindërit.

21.2. Në nëntor të vitit 2015, qeveria shqiptare u dënua nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut të paguajë vlerën mbi 2.000.000 euro për tri familje të shpronësuara nga regjimi komunist. Në gjyq, shteti shqiptar mbrohej nga avokatja e shtetit Alma Hicka.

21.3. Paditësi ishte bashkëshorti E. H., me studion e tij, H. dhe H.. Gjyqi për këtë çështje ka nisur në dhjetor të vitit 2013, i cili ishte aksioner i kësaj shoqërie duke zotëruar 5% të kuotave.

21.4. Në 60 çështje të komunikuar në janar të vitit 2014 kundër Shqipërisë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, 15 prej tyre përfaqësoheshin nga kjo studio ligjore, me ortak bashkëshortin e saj.

21.5. Në lidhje me çështjen gjyqësore për marrëveshjen me ***, bashkëshorti i subjektit ishte avokat i kontraktuar nga shoqëria “***” në çështje, që kjo shoqëri kishte ngritur kundër Drejtorisë së Tatimeve për një vlerë prej 8.000.000 euro. Subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë formuluar nenin 9 të marrëveshjes që amnistuan penalisht drejtuesit e shoqërisë *** si avokatja e shtetit shqiptar.

21.6. Në pyetësonin e dytë subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të deklarojë nëse ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit dhe në kthim përgjigje të pyetësonit II është shprehur

se: “... kurdoherë, në ushtrimin e çdo funksioni kam respektuar të gjitha detyrimet ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë ...”.

21.7. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua detyrimi për të paraqitur shpjegime për të provuar se referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, nuk ka ushtruar funksionin në kushtet e konfliktit të interesit.

21.8. Subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e dërguara pas barrës së provës ka referuar se informacioni nuk është në gjendje të tregojë një fabul, një ngjarje apo një situatë, që qoftë edhe sipas pretendimeve të veta të njëanshme të jetë e kuptueshme dhe as ka në raport një thelb të konfliktit, as ka identifikim të interesave, aq më pak ka verifikim të tyre dhe vendimmarrjet e gjykatave dhe prokurorisë për to.

21.11. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e mësipërme nga subjekti i rivlerësimit dhe dëgjoi atë në seancën e datës 10.3.2021, duke vlerësuar respektimin e parimit të barazisë së armëve dhe duke mbajtur parasysh të respektojë të drejtat e subjektit të rivlerësimit në këtë proces për të mos lejuar që ajo të vendoset në një gjendje të pafavorshme për shkak të mungesës për të marrë informacion apo mësuar mbi fakte që nevojiten për mbrojtjen e saj efektive, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave, *ex officio*, për të parandaluar çdo disavantazh, vlerësoi t’i japë subjektit të rivlerësimit shpjegime shtesë lidhur me situatën e prezumuar të konfliktit dhe identifikim të interesave si vijon:

21.12. Vendimi nr. 969, datë 25.10.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e grupit të punës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë *** A. S.”, ka për objekt të saj ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për nisjen e procedurës së negociimit dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë në mosmarrëveshjen me shoqërinë *** A. S., që lidhet me Traktatin e Kartës së Energjisë dhe Marrëveshjen e Shitjes së Aksioneve, të miratuar me ligjin nr. 10 116, datë 23.4.2009.

21.13. Pikat 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi përcaktojnë institucionet që do të përbejnë grupin ndërinstitucional të punës, si dhe përbërja nominative e këtij grupi do të përcaktohet me urdhr të Kryeministrit, sipas propozimit të këtyre institucioneve. Me urdhrin nr. ***, datë 2.12.2013 Kryeministri ka përcaktuar emrat e 14 anëtarëve të këtij grupi, i cili kryesohej nga shtetasi D. Gj., Ministër i *** dhe shtetasja Alma Hicka, Avokate e Përgjithshme e Shtetit, ishte anëtare e tij. Dhe sipas përcaktimit të pikës 2, të këtij akti nënligjor, këto institucione caktojnë përfaqësuesit e tyre, ku në interpretim të parashikimit të VKM-së, jo detyrimisht mund të jetë titullari i institucionit, por edhe punonjës të tjerë, mjafton që të kenë njohuritë e nevojshme për çështjet objekt negociimi.

21.14. Si konkluzion i negociatave të grupit të punës është hartuar dhe miratuar nga Kuvendi ligji nr. 114/2014, “Për miratimin e marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë ‘***’ sh. a.” Nëse i referohemi nenit 1.4 dhe 1.8, të marrëveshjes, konstatohet se Avokati i Përgjithshëm i Shtetit është palë nënshkruese e kësaj marrëveshjeje e miratuar me ligjin e sipërcituar.

21.15. Ligji organik nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ka të përcaktuar specifikisht rastet e konfliktit të interesit dhe rolin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), i cili është autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e ligjit. Autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucionet publike sipas parashikimeve në të, janë: (a) eprorët e zyrtarëve, sipas hierarkisë, brenda një institucioni publik; (b) drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore apo njësitë e ngarkuara a të ngritura posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive të çdo institucioni publik; (c) institucionet eprore.

21.16. Konflikti i interesit” sipas definicionit në ligjin nr. 9367/2005, konsiderohet të jetë gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

21.17. Ndërsa në nenin 5, të ligjit parashikohet çfarë janë interesat private të zyrtarit: ato që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: ku ndër të tjera është edhe çdo marrëdhënie juridiko-civile, familjare apo të bashkëjetesës, si dhe angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në përcaktimet e kësaj dispozite (neni 5, pika 1, geramat “b”, “dh”, nënpikat “i” dhe “e”, të ligjit).

21.18. Në nenin 7, të ligjit kemi parashikime për deklarimin rast për rast të interesave private të zyrtarit, dhe ku çdo zyrtar detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak të rastit mbi ekzistencën e interesave private të tij që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti interesi.

21.19. Neni 37 i ligjit parashikon në mënyrë shtjelluese trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave. Këtu ka parashikime edhe për parandalimin sa më të hershëm dhe efikas të konfliktit dhe lidhur me këtë zyrtari paraprakisht sipas rrethanës apo nevojës dhe rëndësisë së situatës, mënjanon dhe zgjidh vetë çdo situatë të konfliktit të interesit ku një nga veprimet që ndërmerr i njihet edhe vetëpërrjashtimi paraprakisht nga procesi konkret i vendimmarrjes, dhe për këtë njofton eprorin ose institucionit epror. Njoftimi i eprorit dhe institucionit epror shoqërohet me dokumentacionin provues që shërben për zgjidhjen e sugjeruar ose të marrë nga zyrtari.

21.20. Eprori i zyrtarit ose institucioni epror, duke filluar nga ai më i afërt, paraprakisht, sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh çdo situatë të konfliktit të interesit të një zyrtari vartës, të çdo forme qoftë ajo, duke përdorur, sipas rastit dhe përshtatshmërisë, disa mënyra dhe nder to janë edhe:

- të mos i ngarkojë zyrtarit detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti interesash;
- të mos lejojë që zyrtari të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.

21.21. Vlen për t’u theksuar se mënyra e trajtimit dhe e zgjidhjes së konfliktit të interesit, bëhet duke u bazuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet zyrtarit dhe eprorit ose institucionit epror, si dhe duke synuar së bashku përdorimin e mënyrës më të mirë për parandalimin dhe zgjidhjen e gjendjes me konflikt interesi. Zyrtari, eprori ose institucioni epror njoftojnë në çdo rast Inspektoratin e Lartë mbi masat e marra për trajtimin dhe zgjidhjen e rastit të konfliktit të interesit.

21.22. Në aspektin procedural trajtimi dhe zgjidhja e konfliktit të interesit nga ana e eprorëve dhe institucionit epror, bëhet duke u bazuar në Kodin e Procedurave Administrative, për të gjitha institucionet publike që i nënshtrohen Kodit apo edhe në ligje të veçanta që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve publike, të drejtat dhe detyrimet e kategorive të ndryshme të zyrtarëve.

21.23. Nisur për sa më lart, si dhe mbështetur në referimin e zgjeruar të parashikimeve të disa prej dispozitave të ligjit nr. 9367/2006, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për avokaturën e shtetit”, (i ndryshuar) dhe të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, (i shfuqizuar), vlerësohet se:

21.24. Subjekti rivlerësues duket se ka qenë në situatën e konfliktit të interesit, duke qenë pjesë e grupit ndërinstitucional të punës, të ngritur me VKM-në nr. 969, datë 25.10.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e grupit të punës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “****” sh.a. Qenia e personit të lidhur e subjektit rivlerësues,

bashkëshortit z. E. H. si përfaqësues i shoqërisë “***” sh. a., në çështje gjyqësore me palë ndërgjyqëse paditës Drejtorinë e Tatimeve Tiranë dhe i paditur *** sh.a., bën pjesë në rastet e konfliktit të interesit kundrejt subjektit rivlerësues.

21.25.Pavarësisht se përfaqësimi ligjor nga ana e personit të lidhur është kryer në një periudhë të mëparshme kohore të caktimit të subjektit rivlerësues në grupin ndërinstitucional të punës sipas VKM-së (sjellim në vëmendje që rezulton vetëm disa muaj më herët), kjo bie në rastet e konfliktit të interesit, duke përfshirë gjendjen e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të subjektit rivlerësues, sipas parashikimeve të nenit 5, pika 1, germa “b”, “dhe nën-pika “ii”, dhe “e”, të ligjit nr. 9367/2006.

21.26. Gjithashtu VKM-ja nr. 969, date 25.10.2013, e Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e grupit të punës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “***” sh. a” nuk specifikon konkretisht që Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, të jetë pjesë e grupit ndërinstitucional të punës, por një ose disa përfaqësues nga ky institucion (pikat 2 dhe 3), me kriterin që të kenë njohuritë e nevojshme për çështjet që do të jenë objekt negocimi. Edhe në eventualitetin e pasjes së këtyre njohurive në dobi të zgjidhjes së çështjes dhe mbrojtjes së interesave shtetërore, përsëri subjekti i rivlerësues gjendej në kushtet e konfliktit të interesit dhe mund të caktonte përfaqësues të tjerë nga institucioni duke njoftuar njëkohësisht edhe institucionin epror.

21.27.Subjekti Alma Hicka nuk rezulton të ketë vetëdeklaruar gjendjen e konfliktit të interesit apo dhe të ketë njoftuar për këtë qëllim institucionin epror, që lidhur me periudhën që konstatohet këto veprime, është Ministri i Drejtësisë sipas neneve 2 dhe 6, të ligjit nr. 10018, date 13.11.2008, “Për avokaturën e shtetit”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

21.28.Subjekti sqaroi: “Baza ligjore për kohën e konstatimit të rastit, si konflikt interesi është ligji nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për avokaturën e shtetit”, ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, dhe ligji nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Në ligjin nr. 10018/2008, neni 24, përmban parashikim të veçantë për konfliktin e interesit lidhur me ushtrimin e detyrës nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe Avokati i Shtetit.

21.29.Në pikën 1, të kësaj dispozite kemi parashikimin që Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe çdo avokat nuk mund të përfaqësojnë shtetin, në rast se ka interesa, të njohura ose jo publikisht, për çështjen në gjykim, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislationit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike. Pra legjislatori e ka të parashikuar një prej rasteve të konfliktit të interesit që lidhet drejtpërdrejtë me funksionin kryesor të institucionit të Avokaturës së Shtetit, që është për çështjet në gjykim.

21.30.Në një vështrim të përgjithshëm të përmbajtjes së kësaj dispozite, krijohet përshtypja se parandalimi i konfliktit të interesit për punonjësit e këtij institucioni të emëruar avokate të shtetit, duke nisur në rang hierarkik nga titullari kryesor, lidhet vetëm me çështjet që janë në gjykim, por në interpretim të parashikimeve të ligjit nr. 9367/2005 dhe të Kodit të Procedurave Administrative, fusha e objektit dhe zbatimit të rasteve të konfliktit të interesit është më e gjerë se një rast i specifikuar dhe i vendosur në një dispozitë konkrete. Për rastet e konfliktit të interesit janë parashikimet e legjislationit të veçante që është ligji nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative.

21.31.Këto 2 akte ligjore specifike janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga institucionet shtetërore dhe organet publike për aq sa këto të fundit bien në fushën e zbatimit të tyre. Në

ushtrim të këtyre funksioneve të tjera ligjore, avokatura e shtetit, kurdoherë mund të ndodhet përpara rasteve të konfliktit të interesit dhe për sa kohë këto raste konstatohen do të zbatohen dispozitat ligjore për shmangien e konfliktit të interesit, ashtu siç veprohet edhe në rastet e çështjeve në gjykim sipas nenit 24, të ligjit nr. 10018/2008, “Për avokaturën e shtetit”. Kodi i Procedurave Administrative, i miratuar me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, ka një sërë parashikimesh për konfliktin e interesit, në nenet 37- 43 të tij.

21.32. Duke iu referuar parashikimit të nenit 37 të ligjit nr. 8485/1999, konstatojmë të listuar rastet e skualifikimit të punonjësit të organit të administratës shtetërore, i cili nuk mund të marrë pjesë në një proces vendimmarrës administrativ, apo në një lidhje kontrate, kur ai/ajo ndodhet në kushtet që bashkëshorti apo bashkëjetuesi ose të afërm të tij deri në shkallën e dytë...kanë marrë pjesë si ekspertë, këshilltara apo avokatë në çështjen në fjalë, pika 1, germa ‘d’, e nenit 37, të ligjit.

21.33. Në vijim të konstatimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të nenëve 38-42, të ligjit nr. 8485/1999, vijohet me aspektin procedural të këtij procesi. Konkretisht, kur punonjësi ndalohet të marrë pjesë në një vendimmarrje apo procedim administrativ, duhet të lajmërojë menjëherë eprorin e tij, i cili merr vendim për përjashtimin nga një vendimmarrje apo procedim administrativ të punonjësit.

21.34. Në këtë rast nëpunësi duhet të ndërpresë çdo veprim për sa kohë eprori nuk urdhëron të kundërtën dhe ku menjëherë pas deklarimit të skualifikimit, zyrtari në fjalë zëvendësohet nga zëvendësi i tij ligjor, përveç rasteve kur eprori e merr këtë çështje nën autoritetin e tij. Vendimi për skualifikimin e nëpunësit jepet brenda një afati 5-ditor. Pra, siç vërehet, dispozitat e kodit të procedurës administrative (ligjit nr. 8485/1999), parashikojnë në mënyrë të detajuar trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit kur punonjësi i 30 administratës shtetërore gjendet para rasteve të tilla.

21.35. Gjithashtu, edhe sipas ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” (pavarësisht se nuk ka qenë në fuqi për rastin e konfliktit të interesit objekt shqyrtimi), në nenin 30, germa “d”, e tij, ka të parashikuar pengesat ligjore kur nëpunësi publik, nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrëse edhe në rastin kur bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë, kanë marrë pjesë si ekspertë përfaqësues, këshilltarë apo avokatë në çështjen në shqyrtim.

21.36. Në këtë rast sipas ligjit, nëpunësi njofton menjëherë me shkrim eprorin e tij, i cili merr vendim për përjashtimin ose konfirmimin e nëpunësit, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit ose kërkesës së palëve dhe kur eprori vendos përjashtimin e nëpunësit në vendimin e përjashtimit caktohet edhe nëpunësi zëvendësues. Për sa më lart, vlerësojmë se në tërësinë e tyre parashikimet dhe procedurat që ndiqen pas konstatimit të rastit të konfliktit të interesit, janë pothuajse të njëjta në të dyja aktet.

21.37. Në lidhje me konstatimet, ato nuk respektojnë parimin latin legis specialis generalis derogat, pra, që ligjin e posaçëm dërgon/devijon atë të përgjithshëm. Kështu, për shkak të natyrës së punës, në avokaturën e shtetit, çështja e konfliktit të interesit dhe përjashtimit lidhet më çështjet konkrete.

21.38. Kjo ngjan edhe me punën e gjyqtarit, kur përjashtimi është për çështjet konkrete. Prandaj në këtë kuptim ligji i përgjithshëm nuk zbatohet përmbi atë të posaçmin, në çështjet që ky i fundit i përcakton posaçmërisht. Megjithatë edhe sikur të marrim të mirëqenë pozicionin tuaj, se ligji i përgjithshëm zbatohet dhe konkretisht siç thoni Ju, Kodi i Procedurave Administrative, i miratuar me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, në nenet 37- 43 të tij.

21.39. Duke iu referuar parashikimit të nenit 37 të ligjit nr. 8485/1999, në të cilin parashikohet: “Neni 37 Rastet e skualifikimit 1. Asnjë punonjës i organeve të administratës nuk mund të

marrë pjesë në një proces vendimmarrës administrativ apo në një lidhje kontrate ku administrata që ai përfaqëson është palë në rastet kur punonjësi ka ose/dhe dyshohet të ketë kushtet e mëposhtme: (a) ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë; (b) bashkëshorti apo bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes direkt apo indirekt në çështjen në fjalë; (c) punonjësi apo personat e parashikuar nga paragrafi b) i këtij neni kanë një interes direkt apo indirekt në një çështje të ngjashme me çështjen në fjalë; ç) punonjësi ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar apo avokat në çështjen në fjalë; d) personat e përmendur në paragrafin b) të këtij neni kanë marrë pjesë si ekspertë, këshilltarë apo avokatë në çështjen në fjalë;

21.40. Vendimi për negociim është marrë nga Këshilli i Ministrave, në VKM përkatëse, pra ka qenë një vendim politik, për të ndryshuar qasjen nga konflikti, nga luftë në arbitrazh në zgjidhje me mirëkuptim, me të gjitha garancitë ndërkombëtare të ndërmjetësimit nga Komiteti Ndërkombëtar i Energjisë në Vjenë. Nga ana tjetër, vendimmarrjen për miratimin e marrëveshjes e ka marrë Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi, pa miratimin e të cilëve nuk do të kishte marrëveshje. Pra, qartazi, rolin vendimmarrës e kanë këto institucione.

21.41. Sa i takon nënshkrimin të marrëveshjes nga ana ime, ky nënshkrim ishte në kuadër të detyrës time, dhe nuk mund të transformohej në një rol vendimmarrës kur ligji dhe detyra ma japin një rol këshillues. Sigurisht edhe unë si pjesë e grupit të punës në detyrën time funksionale kam nënshkruar marrëveshjen për këshillimin që kam dhënë.

*21.42. Në përfundim edhe Ligji për konfliktin e interesit, edhe rastin kur do të ekzistonte gjendja e konfliktit të interesit, e lidh atë me qenien e subjektit, vendimmarrës, kryesor ose thelbësor në atë procedurë. Qartazi kam argumentuar më lart, që unë nuk ka pasur rol vendimmarrës por vetëm këshillues, se i tillë është roli dhe funksioni i Avokaturës së Shtetit dhe i çdo avokati në përgjithësi. Nuk ka asnjë dispozitë ligjore, por as edhe ndonjë logjikë njerëzore, që të shoh një lidhje interesi në këtë çështje. As unë as bashkëshorti im në asnjë moment as përpara as pas fillimit. Kam shpjeguar dhe rishpjegoj se *** sh.a. është një shoqëri e të drejtës shqiptare, me personalitet juridik dhe interesa të ndryshme nga *** sh. a., e cila është një shoqëri e të drejtës ceke, të detyrës nuk kemi pasur asnjë interes, as të fshehtë, as të hapur, as pasuror dhe as të ndonjë lloji tjetër për këtë çështje. Në përfundim në këtë procedurë, në asnjë rast dhe për asnjë rrethanë nuk kam qenë në kushtet e konfliktit të interesit”.*

Komisioni, pasi analizoi qëndrimin e subjektit të rivlerësimit për konfliktin e interesit, vlerëson se:

21.43. Baza ligjore për kohën e konstatimit të rastit, si konflikt interesi është ligji nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për avokaturën e shtetit”, ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, dhe ligji nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

21.44. Në ligjin nr. 10018/2008, neni 24, përmban parashikim të veçantë për konfliktin e interesit lidhur me ushtrimin e detyrës nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe Avokati i Shtetit. Në pikën 1, të kësaj dispozite është parashikimi që Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe çdo avokat nuk mund të përfaqësojë shtetin, në rast se ka interesa, të njohura ose jopublikisht, për çështjen në gjykim, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

21.45. Pra, legjislatori e ka të parashikuar një prej rasteve të konfliktit të interesit që lidhet drejtpërdrejt me funksionin kryesor të institucionit të Avokaturës së Shtetit, që është për çështjet në gjykim. Në një vështrim të përgjithshëm të përmbajtjes së kësaj dispozite, krijohet përshtypja se parandalimi i konfliktit të interesit për punonjësit e këtij institucioni të emëruar

avokate të shtetit duke nisur në rang hierarkik nga titullari kryesor, lidhet vetëm me çështjet që janë në gjykim, por në interpretim të parashikimeve të ligjit nr. 9367/2005 dhe të Kodit të Procedurave Administrative, fusha e objektit dhe zbatimit të rasteve të konfliktit të interesit është më e gjerë se një rast i specifikuar dhe i vendosur në një dispozitë konkrete.

21.46. Për rastet e konfliktit të interesit janë parashikimet e legjislacionit të veçantë që është ligji nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative. Këto 2 akte ligjore specifike janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga institucionet shtetërore dhe organet publike për aq sa këto të fundit bien në fushën e zbatimit të tyre.

21.47. Për analogji si dhe për nga rëndësia të ngjashme edhe me pozitën institucionale të Avokaturës së Shtetit, referuar nenit 41, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenit 51 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, dhe nenit 22 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, dhe ligje të tjera, ka parashikime që përmbajnë konfliktin e interesit, deklarin dhe parandalimin lidhur me të.

21.48. Në këto raste nuk specifikohet se cilat konsiderohen raste të veçanta të konfliktit të interesit, duke referuar që raste të tilla janë të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi. Nëse do të mbështeteshin vetëm në rastin e identifikimit të konfliktit të interesit kur Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe avokatët e shtetit përfaqësojnë shtetin në çështjet gjyqësore, do t’i bënin një interpretim dhe analizë të paplotë madje të cunguar parashikimeve të rasteve të konfliktit të interesit.

21.49. Në referim të nenit 5, të ligjit nr. 10018/2008, disa prej funksioneve të Avokaturës së Shtetit janë të tilla si ofrimi i shërbimit këshillimor për veprimtarinë juridike të organeve të administratës shtetërore qendrore dhe të enteve publike, veçanërisht për lidhjen e kontratave, të cilat parashikojnë efekte financiare për shtetin, ofrimi i asistencës juridike njëjësive të qeverisjes vendore, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligj ose në marrëveshje të posaçme, të lidhura për këtë qëllim, ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe organeve të qeverisjes vendore, ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe enteve publike, etj.

21.50. Në ushtrim të këtyre funksioneve të tjera ligjore, avokatura e shtetit, kurdoherë mund të ndodhet përpara rasteve të konfliktit të interesit, dhe për sa kohë këto raste konstatohen, do të zbatohen dispozitat ligjore për shmangien e konfliktit të interesit, ashtu siç veprohet edhe në rastet e çështjeve në gjykim sipas nenit 24 të ligjit nr. 10018/2008, “Për avokaturën e shtetit”.

21.51. Kodi i Procedurave Administrative, i miratuar me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, ka një sërë parashikimesh për konfliktin e interesit, në nenet 37-43 të tij. Duke iu referuar parashikimit të nenit 37 të ligjit nr. 8485/1999, konstatohen të listuara rastet e skualifikimit të punonjësit të organit të administratës shtetërore, i cili nuk mund të marrë pjesë në një proces vendimmarrës administrativ apo në një lidhje kontrate, ... kur ai/ajo ndodhet në kushtet që bashkëshorti apo bashkëjetuesi ose të afërm të tij deri në shkallën e dytë ... kanë marrë pjesë si ekspertë, këshilltarë apo avokatë në çështjen në fjalë”, pika 1, germa “d”, e nenit 37, të ligjit.

21.52. Në vijim të konstatimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të neneve 38-42, të ligjit nr. 8485/1999, vijohet me aspektin procedural të këtij procesi. Konkretisht, kur punonjësi ndalohet të marrë pjesë në një vendimmarrje apo procedim administrativ, ai duhet të lajmërojë menjëherë eprorin e tij, i cili merr vendim për përjashtimin nga një vendimmarrje apo procedim administrativ të punonjësit.

21.53. Në këtë rast nëpunësi duhet të ndërpresë çdo veprim për sa kohë eprori nuk urdhëron të kundërtën dhe ku menjëherë pas deklarinimit të skualifikimit, zyrtari në fjalë zëvendësohet nga

zëvendësi i tij ligjor, përveç rasteve kur eprori e merr këtë çështje nën autoritetin e tij. Vendimi për skualifikimin e nëpunësit jepet brenda një afati 5-ditor. Pra, siç vërehet, dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative (ligjit nr. 8485/1999), parashikojnë në mënyrë të detajuar trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit kur punonjësi i administratës shtetërore gjendet para rasteve të tilla.

21.54.Gjithashtu edhe sipas ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, (pavarësisht se nuk ka qenë në fuqi për rastin e konfliktit të interesit objekt shqyrtimi), në nenin 30, germa “d”) e tij, ka të parashikuar pengesat ligjore kur nëpunësi publik, nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrëse edhe në rastin kur bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë, kanë marrë pjesë si ekspertë përfaqësues, këshilltarë apo avokatë në çështjen në shqyrtim. Në këtë rast sipas ligjit, nëpunësi njofton menjëherë me shkrim eprorin e tij, i cili merr vendim për përjashtimin ose konfirmimin e nëpunësit, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit ose kërkesës së palëve dhe kur eprori vendos përjashtimin e nëpunësit, në vendimin e përjashtimit caktohet edhe nëpunësi zëvendësues.

21.55.Për sa më lart, vlerësohet se në tërësinë e tyre parashikimet dhe procedurat që ndiqen pas konstatimit të rastit të konfliktit të interesit, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se nuk ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit në këtë çështje, por për sa kjo ishte një veprimtari jashtë objektit të veprimtarisë së ligjit nr. 84/2016, ky rast i konstatuar u vlerësua nga trupi gjykues se nuk mund të shërbejë si shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion për rivlerësimin e pasurisë

20.56.Për pasurinë **apartament banimi me sipërfaqe 120.3 m²** ndodhur në Tiranë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë “vetting” lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie në vlerën 82.000 euro dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas parashikimeve në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, gërmat “a” “b” dhe 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

21.56.1.Për pasurinë **automjet “Ford Kuga”**, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë “vetting” lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, pasi nuk provoi burimin e ligjshëm të huas 1.800.000 lek perdorur si burim krijimi sipas parashikimeve në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, gërmat “a” “b” dhe 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

21.56.2. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se bazuar në konkluzionet e arritura më lart në konsideratë dhe të standarteve të vendosura nga Kolegji i Posacëm i Apëlimit, subjekti i rivlerësimit znj.Alma Hicka, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

22.Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, DSIK-ja, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin figurës, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur në Komision raportin e deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 18.5.2020, të KDZH-së, ku rezulton se:

22.1Subjekti i rivlerësimit i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës. Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen

dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.

22.2.Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

22.3.Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni pas hetimit të kryer për këtë kriter arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

22.4 Konkluzioni për kontrollin e figurës

Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, arriti në përfundimin se subjekti ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

23.Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” , kreu VI, nenet 40 e vijues i tij, si dhe mbi bazën e kritereve përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga organi kompetent, Këshilli i Lartë Gjyqësor.

23.1.Raporti, për analizën e aftësive profesionale, kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, është bazuar në formularin e vetëdeklarimit bashkë me dokumentet shoqëruese, tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistem objektiv dhe rastësor; të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së.

ANALIZA E GJETJEVE

Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore

23.2.Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, ka filluar punën si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë më 16.9.2004 dhe e ka ushtruar këtë detyrë deri më 15.9.2010, kur është emëruar inspektore në Inspektoratin e KLD-së.

23.3.Ajo ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtarja Alma Hicka kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile, objekt shqyrtimi gjyqësor zbaton me korrektesë procedurën e gjykimit të shkurtuar identifikon rastet për zbatimin e ligjit për uljen e dënimit. Zgjidh drejt mosmarrëveshjet objekt gjykimi dhe, për pasojë, në disa raste, palët bien dakord me zgjidhjen e çështjes dhe nuk e kundërshtojnë vendimin e dhënë në gjykatat më të larta

23.4. Tri dokumentet ligjore, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit kanë lidhje me detyrën funksionale të ushtruar si Avokate e Përgjithshme e Shtetit dhe kanë të bëjnë me përfaqësime në Gjykatën Evropiane, në Arbitrazhin Ndërkombëtar dhe parashtrësia në Gjykatën Kushtetuese.

23.5. Nga pesë dosjet e vëzhguara janë ankimuar 2 prej tyre. Në të 2 rastet, gjykatat më të larta kanë vendosur lënien në fuqi të vendimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ku në 1 rast ka gjykuar me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë .

Arsyetimi ligjor

23.6. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të thjeshtë dhe të kuptueshëm. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme dhe e standardizuar.

23.7. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Nuk përdor referenca në jurisprudencën e gjykatave më të larta. Ajo bën pjesë të arsyetimit të vendimeve gjyqësore edhe çështje të procedurës së gjykimit, të cilat nuk janë kundërshtuar nga palët dhe, për më tepër, janë çështje, për të cilat praktika gjyqësore është konsistente (juridiksioni gjyqësor, kompetenca lëndore dhe tokësore). Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

23.8. Ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, ku pasqyrohet edhe shkaku ligjor. Në rastin e çështjes penale, ku është proceduar me gjykim të shkurtuar, është konstatuar se vendimet e ndërmjetme kanë referencë ligjore, në disa raste referencat lidhen me gjykimin e zakonshëm dhe jo atë të shkurtuar.

Aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

23.9. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për këtë periudhë gjyqtarja Alma Hicka ka gjykuar gjithsej 980 çështje gjyqësore, nga të cilat 512 çështje civile (403 çështje civile të përgjithshme dhe 109 çështje civile të veçanta), si dhe 468 çështje penale (67 krime dhe kundërvajtje dhe 401 kërkesa penale).

23.10. Sipas germës “g”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së rrethit gjyqësor, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe çështjesh civile me palë kundërshtare, pra për 3 vjet jo më pak se 600 çështje.

23.11. Sipas të dhënave statistikore rezulton se gjyqtarja Alma Hicka, për periudhën e rivlerësimit, ka gjykuar gjithsej 470 çështje, 67 çështje penale (krime dhe kundërvajtje) dhe 403 çështje civile të përgjithshme. Rrjedhimisht, ngarkesa e saj sasimore ka qenë dukshëm nën standardin minimal po të shtohet edhe fakti që periudha është 4 vjet e 9 muaj.

23.12. Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Alma Hicka ka qenë në intervale kohore nga 1 muaj e 14 ditë deri në 3 muaj e 9 ditë. Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit 3 muaj e 9 ditë ka qenë çështje adm/penale ulje e dënimit, ku në përfundim të gjykimit është disponuar pranimi pjesërisht i

kërkesës. Në tri dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 16 ditë, 2 muaj e 6 ditë dhe 2 muaj e 12 ditë.

23.13.Ndër këto pesë dosje të vëzhguara është konstatuar se në 4 raste është respektuar afati standard i gjykimit, ndërsa në 1 rast, afati standard i gjykimit prej 2 muajsh është tejkaluar. Shkak për tejkalimin e afatit standard ka qenë lënia e seancës së parë gjyqësore nga gjyqtarja, pas 2 muaj e 3 ditë.

23.14.Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Alma Hicka i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur vendimeve gjyqësore. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 4 ditë nga shpallja për 8 ditë nga shpallja , për 10 ditë nga shpallja dhe për 11 ditë nga shpallja 2 dosjet e para, afatin për arsyetimin e vendimit e kanë 5 ditë, ndërsa 3 dosjet e tjera afatin për arsyetimin e vendimit e kanë 10 ditë. Në këto kushte, arsyetimi i vendimeve në 4 raste ka qenë brenda afatit ligjor ndërsa në 1 rast afati ligjor është tejkaluar me 1 ditë. Megjithatë edhe në këtë rast tejkalimi i afatit ka qenë shumë i vogël dhe për më tepër, palët kanë ushtruar ankim ndaj vendimit dhe Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

23.15.Subjekti i rivlerësimit Alma Hicka e respekton kohën në gjykim si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor dhe i ka gjykuar çështjet brenda afateve standarde të gjykimit, me përjashtim të 1 çështjeje adm/penale, të cilën e ka gjykuar jashtë afatit 2-mujor. Gjithashtu, ajo i ka kushtuar rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve gjyqësore, duke respektuar afatet ligjore në rastet e vëzhguara.

Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

23.16.Subjekti i rivlerësimit Alma Hicka ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje shpejt pas marrjes së akteve të çështjes me short, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore.

23.17.Gjyqtarja Alma Hicka zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Për çdo kërkesë apo hap procedural, merr rregullisht mendimin e të dyja palëve në gjykim. Disponon me vendime të ndërmjetme për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit. Ajo ka respektuar të drejtën e palëve për të siguruar mbrojtës apo përfaqësues.

Aftësia për të administruar dosjet

23.18.Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, përgjithësisht, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore, vendime të cilat janë marrë shpejt pas marrjes së çështjes me short. Në rastet kur seanca nuk është çelur pasi mungon gjyqtarja, është mbajtur procesverbal (shënim) nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtarja, për të pasqyruar këtë fakt dhe për të caktuar seancën e ardhshme.

23.19.Edhe kur seanca gjyqësore nuk është zhvilluar, pasi ka qenë pushim festë zyrtare, është mbajtur ditën e nesërme procesverbal për arsytet e moszhvillimit të seancës dhe caktimi i seancës tjetër gjyqësore duke urdhëruar njoftimin e palëve.

23.20. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpadia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Etika në punë

23.21. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Alma Hicka (shihni të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së). Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

Integriteti

23.22. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia

23.23. Nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka dhe në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve.

23.24. Në një rast konstatohet se gjyqtarja është kujdesur për të pandehurën si individ në nevojë e pandehura pa mjete monetare për t'i siguruar mbrojtës kryesisht, si dhe e ka marrë në konsideratë gjendjen e saj në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar çështje të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar as përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

23.25. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Aftësitë e komunikimit

23.26. Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Alma Hicka komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në gjykim. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse, si gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në pesë dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

Aftësia për të bashkëpunuar

23.27. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Alma Hicka për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

23.28. Subjekti, arsyetimin e vendimeve gjyqësore penale e civile, e ka realizuar brenda afateve ligjore, çka tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

Konkluzion për vlerësimin e aftësisë profesionale

23.29.Trupi gjykues, bazuar në konstatimet e mësipërme, argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas një analize në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit znj.Alma Hicka ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësisë profesionale.

DENONCIMET

24.Në Komision janë regjistruar dy denoncime, si vijon:

24.1 Denoncim me nr. * prot., datë 29.9.2020**, i Galerisë Kombëtare të Arteve, regjistruar në Komision ndaj subjektit të rivlerësimit, me objekt shkelje të parimeve procedurale civile nga subjekti për zgjidhje çështjeje regjistruar me nr. *** akti, datë 19.8.2020, përfunduar me vendimin e datës 21.8.2020, për të cilën më parë është dhënë një vendim me të njëjtat palë, objekt dhe shkak ligjor duke shkelur për pasojë parimin e gjësë së gjykuar.

24.2 Denoncim nr. * prot., datë 26.1.2018, i shtetasit I. H.**, drejtuar ndaj subjektit të rivlerësimit në cilësinë e Avokates së Shtetit, për sa i përket çështjes për një kontratë të firmosur nga ndërmarrja “****” (Shqipëri) me shoqërinë “****” (Zvicër) për blerjen e 100.000 tonë grurë dhe 25.000 tonë vaj luledielli. Kontrata garantohej me një letër kredie të shtetit shqiptar. Në gusht të vitit 2014 shoqëria “****” regjistrohet nga regjistri tregtar I VAUD, pra nuk ekziston më. Po në atë kohë kemi marrë një njoftim nga Gjykata e Strasburgut për një zgjidhje konfidente (*dispute settlement*), ku nëse shoqëria do të pranonte çështja të konsiderohej e mbyllur me një pagesë prej 3.728.400 euro, të cilat do të paguheshin nga shteti shqiptar.

24.3. Komisioni, pasi analizoi dy denoncimet e mësipërme sipas ligjit nr. 84/2016 dhe pasi analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte konkrete lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk gjeti *indicie* apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarës.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatores së çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura, në vlerësimin e çështjes në tërësi, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë “vetting” lidhur me burimin e krijimit të pasurive dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, gërmat “a” “b” dhe 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet A, Ç, D, DH dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 61/3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
U shpall në Tiranë, në datën 2.4.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku

